



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Tetor/Nëntor 2007 • Viti XXIV • Nr. 6/7 (157/158) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



ETËRIT E KISHËS – PASURI E MADHE E MËSIMIT TË KISHËS

FAQE 7

(Shkruan: DON MARJAN DEMAJ)



LETËRSIA E ATË GJERGJ FISHTËS (III)

FAQE 16–17

(Shkruan: NDUE UKAJ)



KANTUALI KISHTAR SHQIPTAR I MONS. NIKOLLË MINIT

FAQE 18–19

(Shkruan: AKIL KOCI)



REPORTAZH: MEMENTO MORI – KUJTO VDEKJEN

Dita e Purgatorit

FAQE 10–11

(Shkruan: DON FATMIR KOLIQI)

KËNDVËSHTRIM

Zgjedhjet

Jemi në prag të zgjedhjeve të përgjithshme në vendin tonë, që do të mbahen më 17 nëntor 2007. Këto zgjedhje janë një e drejtë dhe mundësi demokratike e gjithë qytetarëve për të qenë pjesëmarrës në përcaktimin e funksionimit të Shtetit të cilin po e krijojmë.

Sipas Doktrinë Shoqërore të Kishës, “populli është subjekti i autoritetit politik i konsideruar në tërësinë e vet si mbrojtës i sovranitetit. Populli, në formë të ndryshme, ua transferon ushtrimin e sovranitetit të vet atyre që lirisht zgjedh si përfaqësues të vet, por ruan aftësinë që të kontrollojë të vepruarit e qeveritarëve...”

Pra, qytetarët këtë të drejtë duhet ta ushtrojnë me vetëdije të plotë dhe të zgjedhin partinë dhe njerëzit të cilët çmojnë dhe nderojnë historinë tonë të përgjithshme dhe të lavdishme, që e jetojnë të sotmen me përgjegjësi, që janë të mbështetur në vlera qytetare e morale dhe të orientuar kah ardhmëria më e mirë për të gjithë.

Po ashtu, gjithnjë bazuar në Mësimin e Kishës, autoriteti politik duhet të garantojë jetën e rregullt dhe të ndershme të bashkësisë, pa zëvendësuar veprimtarinë e lirë të individëve dhe të grupeve por duke e disiplinuar dhe duke e orientuar atë, në respektimin dhe mbrojtjen e pavarësisë së subjekteve individuale e shoqërore drejt realizimit të së mirës së përbashkët.

Fushata parazgjedhore edhe njëherë dëshmojë pjekurinë dhe maturinë popullore e strukturave tona politike për të krijuar bashkëpunim dhe përplotësim në udhëheqjen e vendit drejt një të ardhme politikisht dhe ekonomikisht të qëndrueshme.

Shpresojmë dhe urojmë që kjo atmosferë vëllazërore dhe demokratike të shprehet dhe të dëshmohet edhe pas zgjedhjeve, duke tejkaluar kështu interesat personale e partiake, gjithnjë për të mirën e përbashkët të Kosovës.

Kjo do të na ndihmojë për integrimin sa më të shpejtë dhe të suksesshëm ndërshtetërisë si parakusht për integrimin tonë evropian dhe më gjerë.

Duke shpresuar në zgjedhje të ndershme dhe demokratike bazuar në vlera dhe virtyte, e lusim Zotin që fryti i tyre të jetë paqja dhe mirëqenia për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Prizren, 14 nëntor 2007

+ Dodë GJERGJI



Mbi origjinën ilire dhe vepërimitarinë e Shën Jeronimit (II)

FAQE 14–15

Shkruan: Prof. dr. Jahja DRANÇOLLI e Gjon BERISHA

Intervista me Mons. Damjan Kurti

Famullia duhet të jetë një mini-seminar

FAQE 12–13



Ky monument u punua nga skulptori shkodran Sadik Spahija, kurse e zbuloi përfaqësuesi i kryetarit të Kosovës, Agim Velia, ministër i arsimit, bashk me Moikom Zeqon, nga Tirana dhe Nikë Kajtazin, përfaqësues i diasporës shqiptare në SHBA.

Që 36 vjet më parë kur në Zym të Hasit të Thatë, u themelua Klubi i Letrar “Shtjefën Gjeçovi”, përkatësisht filloi manifestimi letrar, kulturor e shkencor “Takimet e Gjeçovit”, ëndërohej që Gjeçovit të madh t’i ngrihej një shtatore. Megjithatë, symini i zymjanëve, përkatësisht i hasjanëve, filloi të realizohej me fillimin e ngritjes së Kompleksit Përkujtimor “Atë Shtjefën Gjeçovi”, gurin themeltar të të cilit e pat

Shfaqje nga SHKA "Katarina Josipi", Zym



vënë ipeshkvi tashmë i ndjerë Imzot Mark Sopi, në "Takimet e Gjeçovit 2003". Në Kompleksin Përkujtimor kanë planifikuar të vendosin shtatorët e Atë Shtjefën Gjeçovit, Imzot Pjetër Bogdanit, Katarina Josipit dhe të Anton Pashkut. Endërra e zymjanëve tashmë po bëhet realitet. Ditë më parë në atë Kompleks u vendos shtatorja e Atë Shtjefën Gjeçovit.

Në fakt, jehona e kampanave të drekës së ditës së shtunë, më 3 nëntor 2007, e solli Atë Shtjefën Gjeçovin tashmë në bronz (të punuar nga skulptori shkodran Sadik Spahija) nga Kisha e Zymit, ku ai shërbeu, në Kompleksin Përkujtimor "Atë Shtjefën Gjeçovi".

Në manifestimin e organizuar me këtë rast, Greta Dulaj, që e udhëhoqi manifestimin, së pari në emër të zymjanëve përshëndeti të pranishmit, e veçmas Agim Velin, ministër i arsimit të Kosovës, pastaj Sylë Hoxhaj e Mark Komoni, zëvendësmnistri, Hasan Zekaj, përfaqësues i Ministrisë së Kulturës së Kosovës, Hasan Hoti, drejtor i Drejtoratit të Arsimit të Prizrenit, Hasan Luma, drejtor i Drejtoratit të Kulturës së Lipjanit, Thoma Thomai, skulptor, Moikom Zeqo, shkencëtar, Pater Land Jaku, guardian françeskan, Fatmir Miziri, Dylber Neziri e Agim Disha, përfaqësues të Fondacionit Artistik, që të gjithë nga Tirana, Haxhi Galluci, nënkryetar i Bashkisë së Fierit, Skënder Zogaj, kryetar i komunës së Fushë Kosovës, Ton

Marku, kryetar i Unionit Shqiptar në Kroaci e shumë të tjerë.

Më pastaj u ftua nismëtari i kësaj veprimtarie kushtuar Shtjefën Gjeçovit, Frok Kristaj, i cili ndër të tjera tha se jemi tubuar në këtë vend të shenjtë të ngjallim në kujtesën tonë të madhin Atë Shtjefën Gjeçovi. Atë Gjeçovi padyshim se është njëra ndër figurat më të shquara të lëvizjes atdhetare, të kulturës kombëtare, të shkencës dhe të letërsisë shqiptare. Tërë jetën u dallua për dashuri të pakufishme ndaj Atdheut, popullit, kishës, gjuhës amtare, ndaj shkollës dhe artit shqiptar, ndaj vlerave të kulturës materiale dhe shpirtërore të shqiptarëve. Atë Shtjefën Konstantin Gjeçovi – Kryeziu është figurë dhe personalitet poliedrike: mësues dhe dijetar, poet, prozator e gjuhëtar, dramaturg, përkthyes, arkeolog, speleolog, etnograf, folklorist dhe publicist. Mbi të gjitha, ai është atdhetar, rilindës dhe kodifikues i parë i "Kanunit të Lekë Dukagjinit".

Mëhill Gjeçovi, apo siç njihjejmë në rrethin e tij Hili i vogël, që më vonë e mori emrin Shtjefën Gjeçovi, u lind (nga i ati Matë dhe e ëma Ana Gjeçi) në Janjevë, më 12 korrik të vitit 1874. U shkollua në vendlindje, pastaj në Troshan të Shkodrës, në Fojnicë, Dërventë, Banjallukë dhe Kreshevë të Bosnjës e Hercegovinës. Më 25 korrik të vitit 1897, shugurohet meshtar në Zllakuqan të Klinës. Stacionet e shërbimit të tij do të jenë Troshani, Peja, Zllakuqani, Glog-

jani i Pejës, Laçi, Kurbin, Zara (në Dallmaci të Kroacisë), Livno (në Hercegovinë), Shkodër, Gomsiqe, Sapë, Theth, Prekal, Rubik, Vlorë, Gjakovë dhe Zym, ku më 14 tetor të vitit 1929 u pushkatua nga pushteti okupator serb. U varros me nderime të mëdha në varrezat e Kishës së Shën Prenës, në Shëngjergji të Hasit. Studiuesit e jetës dhe veprës së Atë Shtjefën Gjeçovit e kanë konsideruar figurën e tij ndër më të ndritshmet e më të shquarat e historisë dhe kulturës sonë kombëtare. Ndaj, ai është konsideruar por edhe vazhdon të konsiderohet edhe sot, njëra ndër shembëlltyrat më të shkëlqyera për t'ruajtur, ringjallur dhe për t'i bërë të pavdekshme visaret popullore që kanë vlera të jashtëzakonshme. Duke e shpalosur figurën e Atë Shtjefën Gjeçovit, shpalosim aspekte të identitetit tonë kombëtar dhe rrënjët e thella të kulturës sonë, që përkujton edhe disa nga kapitujt më tragjik e më krenarë të historisë sonë.

Atë Shtjefën Gjeçovi na la trashëgim një fond prej më se 10 mijë faqe materiale të fushave nga më të ndryshmet, që përbëjnë më se 75 veptra, prej tyre deri më tash të botuara mbi 25 sosh. Kudo që shërbeu la vullën e shkollës shqipe, la gjurmë në arkeologjinë shqiptare, në sociologjinë e familjes shqiptare, etnografinë... Dhe, pikërisht për kontributin që jepte derisa hulumtonte, shkruante e botonte, edhe Universiteti i Laipjigut të Gjermanisë e laureoi me çmimin Doctor Honoris Causa.

Dhe, në shkrimin "Çka asht Atdheu", që e botoi edhe në veprën "Agimi i Gjydetnis", Gjeçovi ndër të tjera thotë: "Atdhetar i mirë e i ndershem asht në detyrë me dashtë atdheun e vet, e djersët e ballit me i derdhë për dobi të tij;

me i qindrue në kambë çdo urdhëni të tij; me ju ngjit dorën të lanunve e nevojtarëve; me ju ndejtë të parëve në ndigjesë; me këshillue atë që ka mendjen ndërzydash e me genë krejt i atdheut e i kombit... Atdhetar i mirë ka me genë: qeverisë i dëgjueshëm, ushtar trim, prijës zemrak, babë i dash-tun, zotni i njerëzishëm, rroghtar besnik, dashamir i pabishta e shok i mirë".

Duke u nisr nga këto këshilla dhe mësim, por edhe nga fakti se Atë Shtjefën Gjeçovit i pushojnë eshtërat këtu, në vitin 1968, zymjanët e pagëzuan Shkollën fillore me emrin e tij, pastaj në vitin 1971 këtu themeluan Klubin letrar dhe filluam manifestimin letrar, kulturor e shkencor "Takimet e Gjeçovit", por edhe në vitin 2003 filluam ngritjen e këtij amfiteatri që e quajtem Kompleksi Përkujtimor "Atë Shtjefën Gjeçovi", në mënyrë që në këtë amfiteatër të vendosim shtatorën e Atë Shtjefën Gjeçovit, por që më vonë në këtë amfiteatër sipas porosisë së të Madhit Ibrahim Rugova këtu do të vendoset edhe shtatorja e Pjetër Bogdanit e më pastaj edhe të Katarina Josipit e Anton Pashkut, për çka edhe ftojme të na ndihmojnë në radhë të parë hasjanët e po ashtu edhe institucionet shtetërore të Kosovës e të Shqipërisë. Deri më tash banorët e Zymit, Shëngjergjit, Bregdritit e të disa fshatrave të tjera të Hasit, pa asnjë qindërdark të institucioneve të Kosovës, kanë dhënë afro 200 mijë euro për këtë objekt të kulturës dhe për këtë shtatore, përfundoi Frok Kristaj.

Në vazhdim Agim Velin, ministër i arsimit të Kosovës, tha se në emër të Presidentit të Kosovës, z. Fatmir Sejdiu, sjell këtu në Zym përshëndjet e thella dhe falënderimet e singerta për përjetësimin e një figure aq të ndritshme të Rilindjes Kombëtare siç mbetet Atë Shtjefën Gjeçovi, shtatorja e të cilit madhështon jo vetëm Zymin e Hasin, por mbarë Kosovën e shqiptarët.

Në po përkujtojmë një figurë poliedrike të atdhetarit, mësuesit, intelektualit dhe meshtarit

që mëltoi dashurinë për dijen, përparimin, gjuhën shqipe dhe pasurinë e vlerave të traditës popullore, [...] Është përkushtim i përbashkët i institucioneve e qytetarëve të Kosovës, që të realizohet mëvetësia e një kombi autokton, me histori qytetërimi, tradita të lashta dhe vlera të civilizimit euro-perëndimor. Prandaj mund të themi, sot e kësaj dite në Zym, se Atë Shtjefën Gjeçovi po vjen në këtë amfiteatër bashkë me pavarësinë e Kosovës. Ju zymjan të nderuar patët vullnetin dhe mundësitë t'ia ngritni një shtatore madhështore siç ishte Atë Gjeçovi, pishtar i devotshëm i shqiptarizmit, atdhdashurisë dhe i arsimit e kulturës shqiptare. [...] Atë Gjeçovi, me veprën shumëdimensionale në fushën e teologjisë, të arsimit, arkeologjisë, historisë, etnografisë, mbledhjes, sistemit e kodifikimit të të drejtave zakonore shqiptare, mbledhjes së folklorit, në fushën e krijimtarisë së prozës e poezisë, si edhe të përkthimeve, mbetet ndër figurat më të ndritshme të shkencës, kulturës, traditës historike e patriotike shqiptare! Shtatorja e Shtjefën Gjeçovit, hyjnisht reflekton dritë, dije e përparim në Kosovën e pavarur.

Në emër të Presidentit të Kosovës, z. Fatmir Sejdiu, ju përgëzoj për këtë veprë-monument dhe ju qytetarët të Zymit e të Hasit, t'ju falënderoj për këtë përmendore të shenjtë, tha në fund Agim Velin.

Pas fjalimit të rastit, ministri Agim Velin, Moikom Zeqo e Nikë Kajtazi zbuluan shtatorën e Atë Shtjefën Gjeçovit.

Më pastaj, foli edhe Moikom Zeqo, Nikë Kajtazi, Nikollë Kërhanaj, Hile Prekalaj, Dr. Don Shan Zefi, Pater Ndue Kajtazi e Sadik Spahija.

Në fund u shfaq një program i pasur kulturo-artistik i SHKA "Katarina Josipi" të Zymit, që ishte përgatitur nga koreografia Lajde Kolëgjera, program ky që u pëlqye shumë nga pjesëmarrësit e këtij manifestimi.

Albert MARJAKAJ

Liderët fetarë e kanë rolin e krijimit të marrëdhënieve të paqes

Prishtinë, 22 tetor 2007. Asistenti i sekretarit gjeneral të UN-it Ban Ki Mun, zotëri Edmond Mulet, udhëheqës i Departamentit për Operacione Paqeruajtëse (DPKO), në kuadër të vizitës në muajin tetor në Kosovë dhe të takimeve që i pati me Grupin e Unitetit e institucioneve tjera në Kosovë, të atyre vendore e ndërkombëtare, ai më 22 tetor në zyrat e UNMIK-ut në Prishtinë, u takua edhe me prijësit fetarë të Kosovës, përkatësisht ipeshkvin Imzot Dodë Gjergji dhe kryetarin e Bashkësisë Islame Naim Tërnava.

Ipeshkvi Dodë Gjergji edhe myftiu Naim Tërnava, duke shprehur mirënjohjen për misionin e Kombeve të Bash-

va. Z. Mulet, ishte i shoqëruar prej z. Peter Due, asistent i tij dhe znj. Kristina Koch-Avan.

Takimi në fjalë ishte informues për gjendjen aktuale në vend, për zhvillimet e procesit të negociatave për statusin e Kosovës dhe për zgjedhjet që do të mbahen më 17 nëntor të këtij viti. Zotëri Mulet ishte i interesuar të njihje me qëndrimet e bashkësive fetare për pikat e lartpërmendura.

Ipeshkvi Dodë Gjergji edhe myftiu Naim Tërnava, duke shprehur mirënjohjen për misionin e Kombeve të Bash-

kuara në Kosovë, shprehën qartë përkrahjen ndaj procesit të negociatave për statusin e Kosovës që shpresohet të jetë respektimi i vullnetit të popullit, për ta gëzuar të drejtën natyrore të përcaktimit për pavarësi. Imzot Gjergji përmendi gjendjen e vështirë ekonomike që mbretëron në Kosovë, për shkak të moszgjdhjes së statusit. Duhet marrë shumë seriozisht – tha ipeshkvi – shqetësimi i qytetarëve tanë, sepse gjendja aktuale ekonomike është shumë e vështirë – duke shtuar se – madje, vazhdimi i

kësaj gjendje do të shkaktojë largimin e të rinjve nga Kosova. Shpresojmë se përfundimi i negociatave në favor të popullit do të stabilizojë gjendjen dhe do të zbusë dukshëm varfërinë dhe do të ndal largimin e popullit nga Kosova.

Për sa i përket zgjedhjeve, Imzot Gjergji dhe Tërnava, u deklaruan se i përkrahin dhe dëshirojnë të jenë të qeta, dëshirë kjo që është shfaqur edhe hapur para besimtarëve të dy bashkësive.

Z. Mulet, duke i falënderuar për pjesëmarrje në takim i po-

rositi prijësit fetarë ta kenë rolin e krijimit të marrëdhënieve të paqes në vend, duke krijuar kështu ura pajtimi dhe qetësie. Këtë rol duhet aplikuar në mënyrë të veçantë tani kur për Kosovën po zhvillohen procese shumë të rëndësishme. Po ashtu kërkoj që të bëjnë thirrje tek qytetarët për pjesëmarrje në zgjedhje, sepse vetë qytetarët do të jenë ata që do e zgjedhin se kush do i udhëheqë.

Përfaqësuesi i Kishës Ortodokse Serbe nuk ishte i pranishëm. U tha në takim se përfaqësuesi i KOS është takuar një ditë më parë në Manastirin e Deçanit. (Drita)

U mbajtën "Takimet e Gjeçovit 2007"

Manifestim i denjë kombëtar e shpirtëror

U zbulua lapidari "Abetarja e Zymit". Po ashtu, u shënua 70-vjetori i lindjes së Anton Pashkut dhe 10-vjetori i kalimit në amshim i Nënës Tereze. Çmimi "Atë Shtjefën Gjeçovi" iu dha Arbnesheve të Zarës në Dalmaci të Kroaci, kurse "Unaza e Katit" iu dha Ermina Lekajt dhe Lajde Kolëgjerajt.

Në Zym të Hasit të Thatë, komuna e Prizrenit, më 13 tetor (2007) u mbajt manifestimi letrar, kulturor e shkencor "Takimet e Gjeçovit", përkatësisht edicioni i 36-të me radhë i këtij manifestimi. Në këtë manifestim kësaj radhe përveç pjesëmarrësve të shumtë, mori pjesë edhe Arben Çejku, i ngarkuar i Zyrës Ndërlidhëse të Shqipërisë në Prishtinë, Akademik Mark Krasniqi, kryetar i PSHDK-së, Veton Surroi, kryetar i PR "Ora", Sylë Hoxhaj e Kadri Kryeziu, zëvendësministër, Prenkë Gjeta e Skënder Zogaj, kryetar i komunës së Klinës, përkatësisht i Fushë Kosovës, Hasan Luma, drejtor i Drejtoratit të Kulturës të komunës së Lipjanit, Hasan Hoti, drejtor i Drejtoratit të Arsimit të Prizrenit, përfaqësuesit e fshatit Karvansari të komunës së Malishevës e shumë të tjerë.

Do përmendur se manifestimin "Takimet e Gjeçovit" e shpalli të hapur Nikollë Kërhanaj, kurse e përshëndeti Akademik Mark Krasniqi, Veton Surroi, Asqeri Llanaj (nga Vlora) dhe Dr. Don Shan Zefi, famullitar i Zymit.

Në vazhdim Nikollë Kërhanaj foli për "Abetarën e Zymit", kurse lapidarin "Abetarja e Zymit" e zbuluan Arben Çejku e Nikollë Kërhanaj.

Në pjesën e dytë të manifestimit "Ora e Anton Pashkut" së pari Eleonora Luz Prekpalaj deklamoi vargje të Agim Devës e më pastaj u shënua 70-vjetori i lindjes së Anton Pashkut.

Po ashtu, në "Orën e Anton Pashkut" poezit e veta i lexuan Mark Krasniqi, Shqipër Përvizaj, Nehat S. Hoxha, Hatixhe Çolaku – Ademaj, Demush Berisha, Haxhi Vokshi, Arben Rashkaj, Fatime Ahmeti, Fatos Rushiti, Arben Ibrahim, Skënder Zogaj, Vilson Çulaj, Rexhep Smajlaj, Miradije Ramiqi, Shqipe Hasanaj dhe Prend Buzhala.

Organizatorët, si gjithmonë edhe kësaj radhe, dhanë çmimin tradicional për të arritura në kulturë "Atë Shtjefën Gjeçovi". Në fakt, juria e përbërë nga Frok Kristaj, kryetar, Petrit Palushi (nga Kukësi) dhe Isak Ahmeti, anëtarë, kësaj radhe çmimin e përmendur ia ndanë arbnesheve të Zarës së Dalmacisë në Kroaci. Po ashtu organizatorët për të dytën herë me radhë dhanë edhe çmimin "Unaza e Katit" (Katarina Josipit). Kësaj radhe ndanë dy unaza, përkatësisht ky çmim iu dha Ermine Lekajt dhe Lajde Kolëgjerajt. "Unaza e Katit" që iu dha Ermine Lekajt ishte punim i Rafael Kocit, argjentar nga Zagrebi, përkatësisht donacion i Akil Kocit, që e dorëzoi Sylë Hoxhaj, kurse "Unaza..." që iu dha Lajde Kolëgjerajt ishte donacion i Gjokë Kolëndrekajt, që e dorëzoi vet donatori.

Djali i shkrimtarit tashmë të ndjerë Rifat Kukajt, organizatorëve u dhuroi një sasi të ekzemplarëve të romanit më të ri të Rifat Kukajt, që doli nga shtypi ditë më parë, pastaj Greta Kaçinari fali disa ekzemplarë të veprës së Gjergj Kaçinarit, si dhe Hasan Tanushi organizatorëve të manifestimit u dhuroi një këllëf të shkrepës që Gjeçovi ia kishte dhuruar babait të Hasanit.

Do përmendur se në vigjilie të manifestimit, zymjanët promovuan monografinë e Atë Ndue Kajtazit, Nikollë Kërhanajt, Hilë Gjevelekajt e Frok Kristajt "Takimet e Gjeçovit 1971-2006", si dhe shënuan 50-vjetorin e sportit në Zym të Hasit.

Ndërkaq, në lagjen Berishë ku gjendet shtatorja e Nënës Tereze, pjesëmarrësit shënuan 10-vjetorin e kalimit në amshim të kësaj figureje të madhe, për të cilën foli Atë Ndue Kajtazi.

Pjesëmarrësit vunë lule të freskëta mbi varrin e Atë Shtjefën Gjeçovit, Atë Luigj Palajt, Katarina Josipit, Anton Pashkut, që gjenden në fshatin Shëngjergj, si dhe te shtatorja e Nënës Terezës në lagjen Berishë të Zymit.

Në fund, programin e vazhdoi SHKA "Katarina Josipi" e Zymit, ku së pari u paraqit me një këngë Greta Dulaj, që edhe e moderoi programin, e pastaj anëtarët e kësaj shoqërie interpretuan rite të Festës së Bajramit dhe hodhën valle tradicionale e artistike, që u pëlqyen shumë nga të pranishmit.

Frok KRISTAJ

U kremtua festa e Zojës së shenjtës Rruzare



Truporja e Zojës Rruzare në Bishtazhin

Të dielën, më 07 tetor 2007 u kremtua festa e kishës së Bishtazhinit (afër Gjakovës) – Zoja e shenjtës Rruzare.

Megjithëse koha nuk ishte fort e mirë, nderuesit e Zojës Rruzare u bashkuan në një numër të madh rreth kishës së Nënës së vet qiellore. Fatbardhësisht, në fillim të meshës u ndal shiu, kështu që populli me kënaqësi mund ta përcillte Meshën e shenjtë, të cilën e udhëhoqi ipeshkvi ynë, mons. Dodë Gjergji. Së bashku me të, Meshën e kremtuan edhe 16 meshtarë, kurse disa të tjerë ishin në disponim për trëfime.

Në Meshë kanë marrë pjesë edhe një numër i madh i motrave të nderit (rregulltare të kongre-

gatave të ndryshme), si dhe dy grupe të ushtarëve të KFOR-it: komandanti i KFOR-it gjeneral Xavier De Marniac, me përcjelljen e vet – dhe komandanti i KFOR-it italian, gjeneral Antonio Venci, po ashtu me përcjelljen e vet.

Meshën e udhëhoqi ipeshkvi ynë, i cili në predikim e theksoi rëndësinë e lutjes – sidomos të lutjes familjare të Rruzares, e cila familjen e afron, e bashkon dhe ia siguron bekimin e Zotit dhe mbrojtjen e Zojës së Bekuar.

Meshën e ka përcjellë me këngë të bukura kori i famullisë

së Bishtazhinit, i drejtuar nga motrat Baziliane, që në kohë të fundit janë angazhuar në këtë famulli.

Në fillim të meshës famullitari i ri i Bishtazhinit, don Rrok Gjonllëshaj, i përshëndeti të gjithë të pranishmit, kurse në mbarim të gjithëve u falënderua – duke ia dhënë fjalën edhe ish famullitarit të Bishtazhinit, don Viktor Sopit, i cili edhe një herë i përshëndeti besimtarët që i kishte shërbyer mbi 20 vjet – para se u transferua në Ferizaj.

(www.kisha-katolike-gjakove.com)

Imzot Dodë Gjergji, gjatë predikimit



VATIKAN: Lumnimi më i madh në historinë më të re të Kishës



▼ Dy pamje nga Sheshi i Shën Pjetrit ▼



E vërteta është kufiri i çdo pushteti dhe dhune

Lumnimi i 498 martirëve spanjollë, ftesë për përtëritjen e jetës së krishterë

VATIKAN 28. 10. 2007. Në kornizën madhështore të Sheshit të Shën Pjetrit në Vatikan, të pasur me simbole, ngjyra e tinguj, u kremtua Mesha solemne për lumnimin e 498 martirëve spanjollë të periudhës 1934-1937.

Kremtimin, me ritin e lumnimit, e kryesoi Kardinali Zhozë Saraiva Martins, prefekt i Kongregatës për Çështjet e Shenjtërve, në bashkëkremtim me tre kardinalët e Spanjës, Antonio Maria Rouco Valera nga Madridi, Antonio Canizares Llovera nga Toledo dhe Carlos Amigo Vallejo nga Sevilla, me 75 ipeshkvij, priftërinj e rregulltarë të shumtë e në praninë e një numri të madh besimtarësh e shtegtarësh. Në meshe merite pjesë edhe ministri i punëve të jashtme të Spanjës Miguel Angel Moratinos.

Dukej sikur kishin ngarendur nga të katër anët e botës, për të qenë të pranishëm në këtë kremtim të jashtëzakonshëm, kur u ngrit në nderimet e lterit grupi më i madh i martirëve në historinë e lumnimeve: ipeshkvij, priftërinj, rregulltarë, rregulltare e shekullarë, simbol i madhështisë së Kishës spanjolle e sidomos, i Kishës katolike universale, siç e theksoi edhe kardinali Martins gjatë homeliës së kremtimit.

"Ky grup kaq i madh martirësh – theksoi Hirësia e Tij – e dëshmoi deri në martirizim dashurinë e vet ndaj Jezu Krishtit, besnikërinë

ndaj Kishës katolike dhe ndërmjetësimin para fronit të Hyjit për mbarë botën. Para se të vdisnin, martirët i falën persekutorët, madje u lutën për ta, duke dhënë kështu dëshminë më të lartë për vërtetësinë e fesë."

Më pas kardinali Martins, pasi shpjegoi se ky kremtim mbahej në një vend me vlera të vërteta historike, vuri në dukje edhe simbolet e lumnimit: Kryqin e kuq, simbol i dashurisë deri në dhurimin e gjakut për Krishtin dhe palmën e stilizuar, në trajtën e gjubëve të flakës, simbol i fitores së martirëve mbi botën e zjarrit të Shpirtit Shenjt, që digjet, por nuk shuhet kurrë. E të gjitha simbolet, rrethuar si me kornizë nga fjalët: "Lumnimi i martirëve të Spanjës" – që të kujton hartën e botës. E si lajtmotiv i gjithë kremtimit – tha Hirësia e Tij – është zgjedhur një frazë nga Ungjilli i Shën Mateut: "Ju jeni drita e botës". E vërtetë martirët ishin e janë drita e popujve edhe për kohët tona, kur të krishterët kërcënohen në identitetin e tyre, gjë që i bën ta ndëjnë fuqimisht atmosferën e martirizimit, sepse jeta e krishterë është dëshim i përditshëm i besimit në birin e mishëruar të Hyjit, deri në martirizim. E kjo është paradigma e kësaj së vërtetë që nga Rrëshajët.

Martirët që lartohen sot në nderimet e lterit – vijoi kardinali Martins – u kujtojnë burrave e grave të kobëve tona se të gjithë jemi të thirrur për të ecur në rrugën

e shenjtërisë, ashtu si na e kujton edhe Koncili II i Vatikanit. Jeta e krishterë nuk mund të kufizohet vetëm në disa gjeje mëshirë e bamirësie, ajo dubet jetuar në çdo çast të rrugës sonë mbi këtë tokë, në se duam që Jezu Krishti të jetë i pranishëm mes nesh e të na mësojë ta gjejmë madhësinë në kryerjen e detyrave tona të përditshme. Kështu dëshmia jonë e thjeshtë, do të lartësohet në atë, që Gjon Pali II e quajti: "niveli i lartë i jetës së zakonshme të krishterë" e do të bëhet tharm në ngjarjet më të rëndësishme të historisë së njerëzimit. Po përfundojmë – tha Hirësia e Tij – të bashkuar me Papën Benedikti XVI dhe me Kishën universale, që shtrihet në të pesë kontinentet, duke iu lutur martirëve të lumnuar sot të ndërmjetësojnë për ne, që, të përfllakur nga dëshira e gjallë e shenjtërisë, të ndjekim shembullin e tyre.

Të lumtë e rinj

Martirët e rinj të lumë janë kryesisht meshtarë dhe rregulltarë, xhakonë, studentë të teologjisë e laikë, të moshës prej 16 deri 78 vjeç, të vrarë gjatë viteve 1934, 1936 dhe 1937 të kohës së regjimit republikan spanjoll dhe nën ushtrinë e gjeneralit Francisco Franco. Në mesin e këtyre martirëve të lumë janë edhe dy ipeshkvij.

Të kujtojmë se Papa Gjon Pali II që nga viti 1987, e gjatë kohës së pontifikatit të tij, i ka shpallur rreth 500 martirë të lumë të

luftës qytetare spanjolle. Edhe ky akt i fundit ka arritur numrin 978 të martirëve të një kombi, numri më i madh në historinë e re të Kishës.

Lumnimi i këtyre viktimave të luftës qytetare spanjolle ka nxitur edhe shumë diskutime në Spanjë, pikërisht kur në Parlamentin spanjoll në Madrid ka filluar shqyrtimi i dokumentit "Kujtimi historik", i cili i rehabiliton viktimat e Francos dhe në opinion ofron "çelës" të ndryshëm të interpretimit të kësaj periudhe të luftës qytetare spanjolle.

Por Kisha në Spanjë edhe një herë ka treguar se nuk do të implikohet në çështjet e politikës (ditore). Ajo vetëm donë të shpall të lumë dëshmitarët e kishës gjatë asaj kohe salvimesh e persekutimesh. Ajo nuk turravrapet pas fajtorëve, por përmes këtij akti të shenjtë kërkon lavdinë e Hyjit dhe të mirën e njerëzve. Këtë dimension të lumnimit e theksoi në predikimin e vet edhe kremtuesi i meshe kardinali José Saraiva Martins.

Martirizimi: ta jetosh ungjillin pa kompromis

Mbi martirët e rinj spanjoll ka folur edhe Papa Benedikti XVI para lutjes "Engjëlli Tenzot". Papa në fjalën e tij theksoi se martirë janë të gjithë ata që e kanë paguar me jetë besnikërinë ndaj Krishtit dhe Kishës, por jo vetëm ata por martirë janë edhe

të cilët bartin "jo pak martirizimin shumë domethënë" duke e "jetuar ungjillin pa kompromis".

Ky numër i madh i martirëve "tregon se dëshmimi i lartë me gjak nuk është privilegj për një numër të vogël të të krishterëve. Me pagëzim të krishterët janë të obliguar të marrin pjesë në përhapjen e Mbretërisë të Hyjit, kur kërkohet e domosdoshme edhe me fljimin e jetës së tyre. Dhe martirizimi nuk do të thotë të jetë vetëm me derdhje gjaku, siç janë këta martirë spanjoll, që mbetet martirizim i mundshëm për çdo të krishterë. Burra e gra të moshave dhe niveleve sociale të ndryshme e kanë paguar besnikërinë e vet ndaj Krishtit dhe Kishës me jetë. Po ashtu, është e rëndësishme dëshmia e heshtur dhe heroike e shumë të krishterëve që e jetojnë ungjillin pa kompromis." Isha ndër të tjera Ati i Shenjtë, duke e dhënë si shembull të këtij dëshimimi krishteror nënën e më vonë rregulltaren Celin Chludzinsk Borzeck, që u shall e lume një ditë më parë. Ky martirizim i jetës së përditshme në shoqërinë e sotme shekulare, është i nevojshëm me tepër se kurrë – tha Benedikti XVI – duke i kujtuar po ashtu edhe të lumtë e shpallur gjatë muajit tetor në Brasil dhe në Austri: Albertin Berkenbrock, Emmanuel Gómez Gonzáles, Adilio Daronch dhe Franz Jägerstätter.

(radio vatikani shqip dhe Drita)

Kujdesi për Shpirtin në kulturën antike greke dhe në atë të krishterë

■ SHKRUAN:
Don Anton UKAJ

“Ç’dobi ka njeriu nëse e fiton mbarrë botën, por humb jetën? E çka mund të japë njeriu si shkëmbim për jetën e vet?” (Mt 16, 26). Shën Luka, ungjilltar, e thotë kështu: “Ç’dobi ka njeriu nëse e fiton botën mbarrë dhe pastaj humb dhe e shkatëron vetveten?” (Lk 9, 35).

Nuk është hera e parë që lexohen këto fjalë, të sjella nga ungjilltarët në përputhshmëri me njëri-tjetrin. Përmbytja e këtyre fjalëve, në esencë, është kjo: realiteti njerëzor është bashkimi i dy elementeve. Njëri i përbërë nga dimensionet biologjik dhe nga aktiviteti, interesa që janë imanente ndaj ekzistencës dhe prandaj kalimtare. Me vdekje, e tëra kjo ka përfundimin e vet. I dyti: ajo që mbetet nga njeriu dhe që nuk shkatërohet kurrë nuk janë gjërat kaluese, por është uni, personaliteti i tij, ajo çka me një fjalë mund ta quajmë ‘shpirt’. Shprehja paksa dalluese që përdor Shën Luka ungjilltar, evidenton identifikimin e shpirtit të njeriut me vetë njeriun, me pjesën e tij jomateriale, jo të rastësishme, të pavdekshme. Shpirti është vetvetja, UNI i tij. Nga një refleksim i thjeshtë dhe realist, del në pah menjëherë dallimi mes dy vlerave të bashkuara: nga një anë gjendemi përballë një varg faktorësh që e përfshijnë jetën njerëzore dhe që kanë një rëndësi të madhe: shëndeti, puna, suksesi, realizimi, dashuria, interesat materiale, kontoja bankare, qetësia ekonomike, shtëpia. Të gjitha gjërat për të cilat duhet absolutisht preokupim.

Porosia biblike dhe doktrina sociale e Kishës obligojnë qenien njerëzore të preokupohet për të gjitha këto. Megjithatë, duhet pasura parasysh që flitet për gjëra të rëndësishme, themelore, por asesi nuk duhet të mendohen si absolute. Njeriu nuk ju nënshtrohet vetëm dimensionit tokësor, edhe pse duhet të angazhohet në realizimin e tij. Ekziston një komponent tjetër në jetën e njeriut që duhet ta ketë përparësinë, pikërisht pse është i pavdekshëm.

Edhe mbi këtë ungjilli na sjell një shembëlltë shumë instruktive: “Tokat e një pasaniku i dhënë fryt të madh. Ai mendonte me vete e thoshte: ‘Ç’të bëj? Nuk kam më vend ku të mbledh të

lashtat e mia. Dhe tha: ‘Kështu po bëj: do t’i rrëzoj grunarët e do t’i punoj më të mëdhenj dhe do t’i mbledh në ta të gjitha: grurin dhe të gjitha të lashtat e mia. Atëherë do t’i them shpirtit tim: shpirti im, ke pasuri me shumicë për shumë vjet: pusho, ha, pi, gëzo! Porse Hyji i tha: ‘I marrë! Pikërisht sonte, në këtë natë, do të kërkohet shpirti yt prej teje, e ç’grumbullove kujt do t’i mbesë? Kështu i ndodh atij që grumbullon pasuri për vete e nuk kujdeset të bëhet i pasur në Hyjin” (Lk 12, 16-21).

Një lexim i përsheptuar do të mund të bënte të mendohej që këto refleksime janë të krishtera në atë aq sa janë të përmblendhura në Ungjill, bëhen pjesë e një vizioni të krishterë dhe kanë të bëjnë me fatet e përjetshme, parajsë-fer.

Ky interpretim nuk është i gabueshëm, por ekskluziv. Në fakt, mund të shtyjnë të mendohet që refleksimet e tilla të jenë monopol i krishterimit dhe, për këtë, përfshijnë vetëm ata që i përkasin këtij religjioni. Edhe më tepër, predikimi i kësaj të vërtete mbi njeriun mund të ndërrohet si formë prozelitizmi, dëshira për t’u imponuar të tjerëve, jo të krishterëve, një koncept të jetës së njeriut në mënyrë tipike krishtere. Ndërsa për një refleksim të hapur dhe shkenzor, të lirë nga paragjykimet ideologjike, jo të kondicionuar nga kultura dominuese, menjëherë do të duhej që nuk flitet vetëm për një zbulim që ka shpikur Jezu Krishti.

A është e vërtetë se ky është mësimi i tij, por një gjë të tillë e gjejmë edhe para Jezusit. Jezusi sigurisht se e ka zgjeruar, e ka thelluar, e ka motivuar, por zanafillën e gjejmë në vitet para Lindjes së Krishtit.

Duhet kthyer mbrapa ndër shekuj për të zbuluar një



Fytyra e Krishtit

paralajmërues, për të zbuluar atë që ka gjetur diçka dhe nga ajo ka bërë një përmblendje themelore të porosisë së tij, një diçka shumë të rëndësishme për njeriun, saqë edhe vdekja do të duhej të jetë më e preferuar për njeriun se sa humbja apo mohimi i atij koncepti të tij antropologjik. Është fjala për Sokratin, i cili ka pjekur në vete këto bindje në shkollën e kulturës filozofike greke. Pjesa themelore e tërës porosisë sokratiane është ajo që ai e quante: “Kujdesi për Shpirtin”. Ky kujdes për shpirtin është formimi i brendshëm i njeriut, formimi i një njohurie të shëndoshë dhe të pashkatërrueshme. Flitet për një aspiratë që dëshiron ta mishërojë të përjetshmen në kohë dhe në vetë qenie. Nuk flitet për një koncept vetëm të krishterë por për

një koncept natyror. Diskursi nuk është religjioz por filozofik – antropologjik.

Të flasësh për përparësinë e shpirtit do të thotë ta shprehësh të vërtetën mbi njeriun si i tillë. Ky është definicioni i madh i Sokratit për njeriun, pasi që për të shpirti është UNI i vetëdijshëm, është personaliteti intelektual dhe moral. “Njeriu është shpirti i tij, nga momenti që është shpirti ai i cili e dallon njeriun nga çdo gjë tjetër”. Të qartësohet kjo pikë, më duket e domosdoshme, pasi që viteve të fundit flitet shumë për Evropën e re dhe rrënjët e saj. Në lidhje me këtë e ka precizuar mirë Jan

Potacka, ndoshta mendimtar më i madh i Republikës Çeke: “Ajo që këtu përbëhet, me këtë filozofi të kujdesit për shpirtin, është kjo, e cila do të bëjë veçori specifike në jetën evropiane... Evropa ka lindur nga kjo arsye, ia vlen të thuhet nga kujdesi për shpirtin dhe ka ‘vdekur’ për faktin se ka lejuar të mbulohet përsëri nga harresat... Karakteristika e brendshme e krishterimit është e përmblendhur në Platonin vetëm në embrion, në idenë e lirisë dhe të lidhjes të tij me përsosmërinë, me vdekshmërinë dhe të kujdesit për shpirtin. Por, megjithatë, nga ky embrion ka lindur Evropa, e tëra ka lindur nga këtu”.

Nëse Sokrati ka bërë për vete këtë ide, argumenti ishte trajtuar para tij, nga Demokriti. Cila është domethënia e jetës?

Është e nevojshme të arrihet deri në një njohje të thellë të vetvetes, siç thoshte orakulli i Delfit. Por, për ta asimiluar këtë njohje të tillë është e nevojshme një fuqi, një agjent i aftë ta plotësojë këtë aktivitet të mrekullueshëm: shpirtin tonë. Demokriti vazhdon duke nxjerrë përfundimet: kërkohet një disiplinë e shpirtit, për të pasur

kujdes për shpirtin në mënyrë që të jetë i aftë për një detyrë të ngjashme.

Por çka dëshiron të thotë ai me ‘kujdesin për shpirtin’? Preokupimi që ai të jetë i aftë në kontakt me atë që është e përjetshme. Shpirti duhet të lirohet nga gjërat e tepërta që e mbajnë të burgosur në tokësoren. Në zhvillimin e këtij aktiviteti nuk duhet të turpërohem. Kështu shprehet në një fragment: “Nuk duhet të turpërohemi para njerëzve, por para vetvetes”.

Sokrati do të rimarrë trashëgiminë e Demokritit. Shpirti është në kujdes atëherë kur është i orientuar drejtë të mirës. Nga dimensionet intelektual kalohet në atë etik: të bëhet e mira. Matja e asaj që është e mirë është kujdesi i shpirtit për Sokratin. Për të cilin kujdesi për shpirtin është krejtësisht i brendshëm. Në këtë mënyrë shpirti transformohet duke u përmirësuar përbrenda; duke u orientuar drejtë të mirës, identifikohet me të Mirën. Giovanni Reale komenton kështu: “Për Sokratin virtyti është njohje, ndërsa vesi është injorancë. Natyrisht se nuk flitet për një njohje teknike, por për njohjen supreme të së mirës dhe të së keqes, me tërë atë që ajo sjell... Duhet ta koncentrojmë kujdesin tonë mbi një tjetër aspekt: nëse njeriu është shpirti i tij, detyra kryesore e njeriut është ajo që të kujdeset për shpirtin e tij”.

Në fakt, është pikërisht kjo thirrja që Filozofi ua drejtonë vazhdimisht nxënësve të vet: “Nuk duhet të kujdesoheni për trupin, as për pasurinë dhe për asnjë gjë tjetër më tepër se sa për shpirtin, në mënyrë që të bëhet i mirë sa më shumë që është e mundshme”.

Është interesant të vërehet që Sokrati kondicionon bukurinë e trupit me mirësinë e shpirtit. Këtë problem Sokrati e rrah në Karmide. Shpjegon duke thënë: “për t’u bindur për bukurinë e një djaloshi, duhet më parë të kishë sigurinë se ai është në posedim të ‘një gjëje të vogël’, apo përveç trupit, të ketë edhe shpirtin e bukur”.

Kardinal Martini e ka aktualizuar këtë porosi në ditët tona: “Kur takojmë një person të pasur me mirësi, me bujarë, me butësi, me falje, kuptojmë që fytyra e tij apo e saj – edhe nëse është një fytyrë e rrudhur, siç ishte ajo e Nënës Tereze – është e bukur me

“Në filozofin e kujdesit për shpirtin, shfaqet e veçanta e jetës evropiane... Evropa ka lindur nga kjo arsye, ia vlen të thuhet nga kujdesi për shpirtin dhe ka ‘vdekur’ për faktin se ka lejuar të mbulohet përsëri nga harresat... Karakteristika e brendshme e krishterimit është e përmblendhur në Platonin vetëm në embrion, në idenë e lirisë dhe të lidhjes të tij me përsosmërinë, me vdekshmërinë dhe të kujdesit për shpirtin. Por, megjithatë, nga ky embrion ka lindur Evropa, e tëra ka lindur nga këtu.”

Jan Potacka

një bukuri të vërtetë, të shndritshme, të brendshme, shpirtërore, me një bukuri atraktive, sepse rrezaton gëzim, qetësi, harmoni, paqe dhe dashuri.

Senoforti komenton: “Në fakt, Sokrati largon shumë të rinj nga vese të tilla duke i bërë dashurues të virtyteve dhe duke iu dhuruar atyre shpresën që, nëse do të kenë kujdes për vetveten, do të bëhen të shkëlqyeshëm në të bukur dhe në të mirë”. Platonin na hap një rreze tjetër: kujdesi për shpirtin zhvillohet përmes dimensionit reflektues, nga mendimi që hulumton vazhdimisht.

Është shumë e nevojshme që njeriu të zhvillojë kapacitetin e tij mendor dhe të vlerësojë komponentin e tij racional. Megjithatë, është pikërisht ky atentat më i madh që sot i bëhet njeriut post-modern: ta thajë në mendje, ta dehë me lajme, me zhurmë, me mite të rrejshme; e rëndësishme është që ai, pra njeriu, të mos ndalet të mendojë, të reflektojë... e kështu vritet në vetvete.

Në një libër ende të papublikuar “Ungjilli i pestë”, i kardinalit Giacomo Biffi shkruan kështu: “Sot për njeriun është e rëndësishme që të mos mbetet i vetmuar kurrë, as për një moment të vogël, i vetmuar dhe në heshtje. Sepse njeriu ka frikë se do të fillojë të mendojë. Njeriu

post-modern ka frikë të futet në brendësinë e vet, ka frikë të mendojë”.

Kardinali e shpreh një problem shumë të madh dhe tmerues për njerëzit e ditëve tona. Fatkeqësisht ky rrezik është më aktual se asnjëherë tjetër. Bota

te Fedoni, ku lexohet: “Shpirti është e madhja më e madhe e asaj që është hyjnore në njeriun”.

Kur doktrina e krishterë na thotë që Zoti Trini vjen që të banojë në të pagëzuarin, gjen banim në shpirtin e tij, bazohet në garancinë e premtimit të Je-

njeriut, ku ai takohet vetëm me Zotin, zëri i të cilit ndjehet në brendësi” (*Gaudium et Spes*, nr.16). Nga kjo thellësi, Zoti i flet njeriut dhe nga ky intimitet i zemrës Ai takohet me njeriun. Pra, për të krishterin ‘kujdesi për shpirtin’ shndërrohet në interiorizëm, në

dashurinë, sepse Zoti, Ati i Jezu Krishtit dhe Ati ynë, është Zoti i paqes dhe i dashurisë. Tashti mund të kuptohet reflektimi i Shën Augustinit: “O Zot, na ke krijuar për vete dhe shpirti ynë nuk do të gjejë qetësi derisa nuk pushon në ty”. Tomë Kempeni komenton: “Qëndro gjatë me Të në dhomën tënde të brendshme, sepse nuk do ta gësh tjetërkund një paqe kështu të madhe. Por edhe para tij.” Teofane kështu shprehej: “Zoti e kërkon definitivisht zemrën tuaj, dhe zemra e do Zotin, sepse pa Zotin nuk do të jetë as një herë e ushqyer, lodhet me gjithçka”.

Tashti mund të kuptohet bashkëlidhja mes mendimit grek dhe atij të krishterë. Në të parin kujdesi për shpirtin qëndron në praktikimin e virtyteve; në të dytin në dashuri. Thelbi i krishterimit është dashuria. Jeta morale na është logjika pasuese: nëse dikush dashuron, eviton çdo gjë që nuk i pëlqen të dashurit, kështu ai praktikon virtytet. Me këtë nuk dëshiroj ta zvogëlojë intuicionin e thellë grek, sepse Sokrati mund të krahasohet si një profet i madh dhe një përgatitës, i dërguar nga vetë provania hyjnore për ta përgatitur njerëzimin që ta pranojë ndryshimin cilësor të realizuar nga Jezu Krishti me ardhjen e Tij në botë.

“Pjesa themelore e tërë porosisë sokratiane është ajo që ai e quante: “Kujdesi për Shpirtin”. Ky kujdes për shpirtin është formimi i brendshëm i njeriut, formimi i një njohurie të shëndoshë dhe të pashkatërrueshme. Flitet për një aspiratë që dëshiron ta mishëroj të përjetshmen në kohë dhe në vetë qenien. Nuk flitet për një koncept vetëm të krishterë por për një koncept natyror. Diskursi nuk është religjioz por filozofik – antropologjik.”

dëshiron ta formojë një homo technologicus, jo një njeri mendor. E, në këtë mënyrë, varroset kujdesi për shpirtin.

Shpirti në lidhjen e vet me vetveten zbulon përjetësinë. Ai zgjatet drejt përjetësisë dhe problemi më i madh i shpirtit, është lidhja e tij me përjetësinë.

Për Sokratin dhe Platonin shpirti njerëzor është UNI i vetëdijshëm, pjesa më intime e qenies njerëzore. Ky skaj më i fshehtë, i paarrtshëm, i panjohur, nuk është vetëm vendi i personalitetit, por edhe vendi i pranisë së Zotit në krijesën e vet. Mendimi i Sokratit është bartë

zusit: “Nëse ndokush më do, do ta praktikoj fjalën time dhe Ati im do ta dojë dhe ne do të vijmë në të dhe do të gjejmë banim në të” (Gjn 16, 23). Pra, ky tekst shpreh qartë praninë e Hyjnës në ne, gjë që ishte paraparë edhe në kulturën e lashtë greke. Vendi i këtij takimi të shpirtit me Zotin e tij është vetë shpirti, në qendrën më të thellë të qenies së tij. Shenjtërit kanë shkruar kështu: “Zoti banon në qendrën më intime të shpirtit”.

Koncili e ka identifikuar këtë ‘vend’ me ndërgjegjen: “Ndërgjegjja është bërthama me sekrete dhe tempulli i shenjtë i

përqendrim, në jetën bashkuese me këtë Zot që banon në të.

Shën Augustini ka shkruar: “Mos shko larg teje, kthehu në vetvete. E vërteta banon në njeriun e brendshëm”. Jezusi na fton të hyjmë në dhomën tonë dhe ta mbyllim derën. Është fjala për dhomën e shpirtit tonë, ku tokësorja takohet me hyjnoren, e vdekshmja me të përjetshmen. Aty mund të realizohet takimi dashurues mes njeriut krijesë dhe Zotit krijues. Aty është vendi i heshtjes, vendi i paqes, vendi i mirësisë, vendi i dashurisë, vendi i jetës. Dhe kush futet aty, si rezultat do ta ketë paqen dhe



Duart e bashkuara – simboli i përqendrimit dhe lutjes

Etërit e Kishës - pasuri e madhe e mësimit të Kishës

■ SHKRUAN:
Don Marjan DEMAJ

Për *Etërit e Kishës* (lat. *Patres ecclesiae*) është shkruar shumë pak apo nuk është shkruar fare në gjuhën shqipe. Përveç meshtarëve e disa laikëve të pakët, jeta, veprimtaria dhe krijimtaria teologjike e filozofike e etërve të kishës, mund të thuhet, se është e panjohur për lexuesit tanë shqipfolës.

Përmes revistës sonë Drita do të mundohemi që në disa vazhdimë të paraqesim shkurt jetën dhe veprimtarinë teologjike e filozofike të etërve, shkrimtarëve dhe mësuesve të kishës.

Periudha e etërve të kishës, mësuesve, filozofëve, historianëve e krijuesve të tjerë, që llogaritet të jetë e disa shekujve, është një pasuri, madje një thesar i çmueshëm i mendimit teologjik. Ata konsiderohen kolosë të krishterimit, të cilët kanë jetuar në shekujt e parë. Ishin njohës dhe mësues të mirë të krishterimit. Këtë pasuri ata e trashëgojnë nga tradita apostolike, duke qenë disa prej tyre edhe nxënës të nxënësve të apostujve.

Këtë periudhë Kisha e quan *Patrologjia* apo edhe *Patristika*, duke u definuar si mësimi mbi jetën dhe veprimtarinë letrare të shkrimtarëve të vjetër të Kishës. Patrologjia shpesh definohet edhe si letërsi e historisë së vjetër të krishterë. Ajo ndahet në tri periudha:

Periudha e parë nga koha e Besëlidhjes së re e deri tek Edikti i Milanos 313, apo sipas disa autorëve deri të koncilii i Nikesë 325. Kjo ishte kohë kur kishës dhe krishterimit nuk i njihje ende ndonjë status në shoqëri, por ishte bashkësi e marginalizuar e shoqërisë, mund të thuhet se ishte ende si kishë nëntokësore.

Periudha e dytë apo periudha e lulëzimit të Kishës, kohë e artë e literaturës së vjetër të krishterë, që fillon në vitin 313 e zgjatë deri në vitin 451, kur u mbajt koncilii i Kalcidonit. Në këtë periudhë ishte një konflikt i madh pozitiv në mes teologëve sidomos në lindje, dhe qëllimi ishte që të prezantohet sa më mirë trashëgimia e fesë së krishterë dhe të ruhet si e tillë. Në këtë mënyrë, tentohej që të jetë sa më e shndritur në shoqërinë e atëhershme, e cila ishte mjaft e mjegulluar nga sekta dhe politikat e kohës. Roli i etërve gjatë kësaj kohe u shqua posaçërisht në kontributin e mendimit teologjik në koncilët ku u definuan shumë çështje dogmatike e morale.

Periudha e tretë apo periud-

ha e rënies, nga vdekja e papës Leonit të Madh deri në mbarrimin e periudhës patrologjike (në lindje kah vitit 749 deri 826 kur vdiq Shën Teodor Studiti, kurse në perëndim rreth viti 636, kur vdiq Shën Isidori i Sevillës). Karakterizohet me lindjen e shumë çështjeve e problemeve të mëdha rreth kristologjisë. Ishte koha kur në Perandorinë Romake hyjnë njerëz dhe shoqëri të reja. Edhe Kisha e shëh të rrugës që të veprojë në kushte të reja. Si në perëndim ashtu në lindje zhvillohen debate për tu qartësuar dogma e krishterë. Për këtë zhvillohet një letërsi e veçantë që quhej *katena* - komentet e Shkrimit shenjtë, ndërsa në anën tjetër zhvillohet një zhanër tjetër i ashtuquajtur *florilegia*, përmbledhje e citateve të etërve të kishës të krijuara në qëllime të polemikave si "testimonia Patrum", dëshmi e etërve. Këto ishin instrumente më të mirë për të mbrojtur teologjinë e në veçanti kristologjinë.

Fjala "*Atë - Pater*" që bartin këta shkrimtarë, vjen/buron nga relacionet të bir-mësues-nxënës. Nga shek. II në Kishë këtë emër e kanë bartur ipeshkvijtë, kurse nga shek. V quhen shkrimtarë të kishës që ishin të bashkuar me mësimin e Kishës. Për të qenë Atë i kishës, duhet pasur 4 cilësi: 1) shenjtërinë e jetës, 2) mësimin ortodoks të vërtetë, 3) lashtësinë, 4) praninë e mësimit nga ana e Kishës (i ciliar në ndonjë koncil). Nëse njëra prej këtyre cilësive i mungon një shkrimtar, ai mund të quhet vetëm *shkrimtar kishtar*. Më vonë në kishë lajmërohet edhe një titull tjetër, përkatësisht "*Mësues i Kishës*", që u jepet atyre shkrimtarëve që u mungon lashtësia. Gjuha që përdomin këta shkrimtarë ishte greqishtja deri në vitin 180, pas kësaj kohe përdomin edhe gjuhën latine.

Etër të kishës ka 4 në Lindje dhe 4 në perëndim. Në Lindje: Shën Basili i Madh, Shën Gregori Nasiacen, Shën Gjon Gogarti dhe Shën Atanazi. Në Perëndim: Shën Ambrozi, Shën Jeronimi, Shën Augustini dhe Shën Gregori i Madh.

Në në paraqitjen tonë, nuk do të ndalemi vetëm në etërit e kishës që janë 8, por do të zgjerohemi edhe në *shkrimtarë të kishës* edhe në *mësues të kishës*, madje edhe në *etërit apostolikë* (Patres apostolice), që konsiderohen nxënës të drejtpërdrejtë të apostujve, për të paraqitur në mënyrë të thjeshtë e përmbledhtazi pasurinë teologjike të këtyre shkrimtarëve që kanë lënë gjurmë në mendimin tradi-

tor teologjik. Qëllimi i paraqitjes sonë është të nxisim tek shqiptarët dëshirën për studimin e këtyre teologëve të mëdhenj për të thithur pasurinë e mendimit të tyre që edhe sot kanë një autoritet të padiskutueshëm. Sepse ata janë përfaqësues të botës dhe mendimit antik kristian dhe pikërisht për këtë ndikimi i tyre në letërsinë e krishterë ishte e do të mbetet i madh.

Shën Klementi i Romës (30 - 120)

Jeta

Shën Klementi ishte ipeshkvi i katërt i Romës ose trashëgimtar i tretë i Selisë së Shenjtë, pas shën Pjetrit. Është Atë apostolik. Thuhet se vetë shën Pjetri e shuguroi për meshtar (Tertuliani, Jeronimi), ndërsa Origjeni thotë se ishte bashkëpunëtor i Shën Palit, sepse Klementi është ai person, të cilin Shën Pali e përmend në letrën drejtuar Fil 4, 3. Nuk ka të dhëna mbi jetën e tij, por shumë herët (në shekullin e IV) nderohet si martir i Romës. Nuk dimë se me çfarë vdekjeje martire vdiq, por trupin e tij e gjetën në Herfon. Festa e tij në kalendarin liturgjik është më 23 nëntor.

Shën Klementi është njeri, i cili pas vetes la gjurmë të thella në historinë e Kishës. Flitet se ka shkruar shkrime të shumta dhe të ndryshme, por fatkeqësisht deri më sot janë zbuluar shumë pak. Letra drejtuar Korintianëve është një ndër më të njohurat. Këtë letër ai e shkruan në gjuhën greke rreth vitit 95-96. Titulli origjinal është *Kisha e Zotit në Romë, Kishës së Zotit në Korint*. Shkas i kësaj letrë ishin trazirat që ndodhën në Korint. Besimtarët u ngritën kundër autoriteteve kishtarë. Ata sillshin shumë keq me udhëheqësit e vet kishtarë dhe dëshironin t'i largonin nga Korinti. Arsyjeja nuk është e njohur, por Kisha e Romës, pasi dëgjoi për këtë veprë skandalozë, e shëh të rrugës që të intervengojë dhe me një letër të tillë të qetësojë shpirtat e trazuar në Korint. Kjo letër ndër korintas u pranua mirë dhe u arrit qëllimi i paqes dhe pajtimimit ndër vëllezër në bashkësi.

Struktura e Letrës së tij drejtuar Korintianëve

Kjo letër ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë përmban kapitujt 1-38. Në këtë pjesë Shën Klementi ua tërheq vërejtjen që të kenë dashuri, dëgjës, përvujtëri, fe dhe vlera tjera shpirtërore, të cilat do të jenë kusht për jetën

e përbashkët të besimtarëve në Korint. Ja disa fragmente:

"Le të ngulim shikimin mbi Atin dhe Krijuesin e gjithë botës dhe le të lidhemi ngushtë me dhuratat të mëdha dhe të pakrabasueshme të paqes dhe me të mirat e tij. Le të kundërojme në mendjen tonë dhe le të shqyrtojmë me sytë e shpirtit dashurinë e tij kaq zemërgjërë. Ta marrim me mend sa i mirë tregohet me çdo krijesë të tij. Në kapitullin 21,1 Klementi na qorton të mos shkojmë kundër vullnetit të Hyjit duke thënë: "keni kujdes, o shumë të dashur, që të mirat e Hyjit kaq të mëdha dhe të shumta, të mos kthehen në ndëshkim për ne nëse nuk jetojmë në mënyrë të denjë për të, domethënë nëse nuk bëjmë njëzëri çfarë është e mirë dhe e pëlqyeshme para tij. Ta adhurojmë Zotin tonë Jezu Krishtin, gjaku i të cilit është derdhur për ne, të kemi respekt për ata që na qeverisin, të nderojmë pleqtë dhe të mësojmë të rinjtë në njohurinë e druajtjes së Hyjit, Gratë të jenë të mësuar dhe të ecin udhës së të mirës. Të jenë të bijshme në jetën e tyre morale. Ndërsa të rinjtë të ushqehen në thesarin e mësimeve të Krishtit; të mësojnë se çfarë force ka përpara Hyjit përvujtëria, çfarë mund të jetë përpara tij një dashuri e pastër, dhe sa e mirë dhe e madhe është druajtja e tij. Ajo shëlon të gjithë ata që zbatojnë këto shenjtërisht në pastërtinë e shpirtit." Ndërsa në kapitullin e 24 shkruan se "Hyji u rri besnik premtimeve të veta dhe ka përcaktuar çdo gjë dhe me një fjalë mund të shkatërroj gjithçka. Kush do të mund ta pyeste: Çfarë ke bërë? Dhe kush mund t'i kundërvijë forcsë së fuqisë së tij? Veprat e tij ai do t'i përmbush, të gjitha kur të dojë dhe si të dojë dhe asgjë nuk do të bjerë nga ç'ka vendosur ai. Gjithçka është përpara tij dhe asgjë nuk i ikën vullnetit të tij...andaj t'i afrohem në shenjtërinë e shpirtit, të lartësojmë drejt tij duart e pastra dhe pa njolla, ta duam Atin tonë të mirë dhe të mëshirshëm, që na ka bërë trashëgimi të veten."

Pjesa e dytë është prej kapitullit 39 deri në 65. Kjo pjesë merret me problemet e hollësishme që kishin ndodhur në Korint. Zoti ynë Jezu Krishti ka theme-luar hierarkinë e Kishës. Ai vetë dërgon apostujt, të cilët dërgojnë ipeshkvijtë dhe xhakonët. Ai apelon që fajtorët që shkakuan përçarje le të largohen përkohësisht dhe le të bëjnë penesë, derisa të arrihet paqja në bashkësi.

Në kapitullin 40.1 e në vazhdim, shkruan mbi misterin e dashurisë së Krishtit duke thënë: "*Kush ka dashuri në Krishtin i zbaton urdhërimet e Krishtit. Kush është në gjendje ta zbulojë dashuri-*



Shën Klementi i Romës

në e pakufi të Hyjit? Kush mund ta shprehë madhërinë e bukurisë së tij? Lartësia që arrihet me anë të dashurisë, s'mund të tregohet me fjalë. Dashuria na bashkon ngushtë me Hyjin. Me dashuri Hyji na tërboq kab vetja". Këtë pjesë e përfundon me fjalët: "Të lumtë ne, o fort të dashur, në goftë se do t'i zbatojmë urdhërimet e Zotit të bashkuar në dashuri që me anë të dashurisë të na falën mëkatet tona duke e krabasuar me Psalmën 32/31, 1-2. Kjo shpallje lumturie u përket atyre që Hyji i zgjodhi nëpër Jezu Krishtin Zotin tonë. Atij i goftë laudua në shekuj të shekujve. Amen."

"Është shkruar: Bashkohuni me shenjtë, sepse kush do t'i ndjek ata, do të shenjtërohet dhe pyet: Përse ka grindje, hidhërimi, mosmarrëveshje, ndarje dhe luftëra në mes jush? A thua nuk kemi një Hyj të vetëm, një Krisht të vetëm, një Shpirt i biri të vetëm të derdhur përmi ne, një thirrje të vetme në Krishtin? Përse t'i mundojmë dhe t'i shqyejmë gjymtyrët e Krishtit, përse të gohemi pesë kundër trupit tonë dhe të arrijmë deri në atë pikë marrëzie saqë harrojmë se jemi gjymtyrë të njëri tjetrit...? Pasi shtjellon ungjillin sipas Lukës (17,1-2) mbi varjen e gurit në qafë për atë që shkakton lutë të krishterë që të shtrihen para këmbëve të Zotit dhe me lot ta lusin, që pasi të zbutohet, të na e kthejë miqësinë e tij dhe të na vendosë prapë në një vëllazëri dashurie të madhërueshme dhe të pastër. Kjo është dera e drejtësisë që është hapur për jetën... edhe pse ka shumë dyer, e vërteta është ajo e Krishtit."

Letra mbaron me një lutje të gjatë për të krishterët, për udhëheqësit e tyre dhe për mbarë botën.

Specifika e letrës është se ajo i përngjan letrës drejtuar hebrejve, e përshkruar me një fe të thellë, por dëshira është që të mbetet në kuadrë traditave hebraike. Jo pa arsye, sepse disa etër të Kishës thonë se ai është një shkrimtar hebre, i cili u kthye në fenë e krishterë. Këtu shihet se ndikimi ende është i pranishëm.

Klementi ka edhe dy letra *Ad virgines* (të drejtuara virgriave). Autori virgjinë e paramendon si dhuratë të Zotit. Celibati dhe virgjeria për Klementin janë mishërim në Krishtin. Ata janë ndjekësit më të denjë të Jezu Krishtit, por virgjeria dhe celibati, në goftë se nuk lidhen me veprat e dashurisë, nuk e garantojnë shëlbimin.

Familja përballë

Fuqia e familjes është e madhe: asnjë nuk mund të shkëputet prej saj. Ajo është si një rrjet i padukshëm, në të cilin të gjithë janë të lidhur me fije të padukshme me njëri-tjetrin. Ajo është në gjendje edhe të shkatërrojë njerëz, por kur arrin të krijojë një ekuilibër mes qëndrimit më pranë apo më larg mes anëtarëve të saj, familja mund të jetë edhe një vatër e sigurt që u jep anëtarëve të saj strehë dhe ngrohtësi. Në të vërtetë, të gjitha përshkrimet e sotme të familjes tregojnë se ajo është e pandashme me gjetjet dhe dhëniet e kuptimit të ekzistencës njerëzore, veçanërisht me ato kuptimdhënie që rrjedhin nga feja dhe besimi.

■ SHKRUAN:
Pater Shtjefen DODES, SJ

Në ditët e sotme, kur bota, sidomos ajo perëndimore, po përjeton një ndryshim rrënjësor shoqëror dhe kulturor, familja shqiptare, ndoshta pikërisht ajo jotja apo e dikujt që e njeh, po ballafaqohet dhe duhet të ballafaqohet me ndryshime psikologjike, morale dhe fetare, të cilat po përjetojnë si të vështira në lidhje me familjen në të ardhmen.

Për një pjesë të bashkatdhetarëve tanë, ndryshimet që po ndodhin janë pozitive. Ata mendojnë se për shkak të një ndikimi të madh të faktorëve (post) modernë në proceset zhvillimore të shoqërisë dhe kulturës, po zbehet roli tradicional i familjes në shoqërinë tonë duke marrë një fleksibilitet që ndërton një burim të madh për familjen bashkëkohore. Ajo në këtë mënyrë po bëhet më e aftë që të përshatet me realitetet e reja shoqërore.

Disa të tjerë i shikojnë gjërat e reja me pasiguri, turbullim, shqetësim madje dhe frikë. Megjithatë për ta të panjohura, të huaja, risitë marrin format e fantazmave kërcënuese prej të cilave duhet të ruhes, të ikësh apo t'i luftosh disi.

Në gjithë këtë realitet kompleks, familja bashkëkohore, sidomos ajo në vendet e tranzicionit siç është edhe Kosova, si kurrë më parë po ndien nevojën e një orientimi. Kërkohet një rrugëdalje, një qartësi më e madhe në ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm. Në të vërtetë, fjala është për një pjekuri në qasjen racionale ndaj ndryshimeve, marrëdhënieve ndërnjerëzore, komunikimit me rrjedhat e kohës; për një vlerësim të mirëfilltë dhe një qëndrim-marrje sa më reale dhe pozitive ndaj ngjarjeve të së kaluarës që kanë ndikuar dhe ndikojnë në të tashmen, si dhe për një vullnet të mirë në angazhimin optimist për mundësinë e zgjerimit të horizontit, duke i shikuar rrjedhojat në tërësinë e tyre. Kjo do ta liron të dhe aftësonë për një veprim të përshatshëm në ndryshime për të ardhmen.

Familja – vendtakim i personave

Për shumëkënd familja bashkëkohore përbën një fenomen sa të vetëkuptueshëm aq edhe kompleks dhe problematik. Thelbi i familjes në kulturën perëndimore përshkruhet si formë jete institucionalisht e njohur, ku zhvillohen marrëdhëniet fëmijë-prindër, prind-prind (grua-burrë) dhe marrëdhëniet e tyre me të afërmit e tjerë. Ajo është një grup i llojit të vet, detyrat e të cilit kanë domethënie themelore për zhvillimin e individëve veç e veç, shoqërisë dhe ku realizohet,

“E mira e personit si dhe e bashkësisë njerëzore dhe asaj të krishterë është thellësisht e lidhur me mirëqenien e bashkësisë martesore dhe familjare. Për këtë arsye të krishterët së bashku me të gjithë ata që e çmojnë lart këtë bashkësi, i përshëndesin sinqerisht të gjitha ato ndihma të ndryshme, me anën e të cilave bëhet përparimi i kësaj bashkësie të dashurisë dhe merret në mbrojtje jeta dhe bashkëshortëve dhe prindërve u japin mbështetje në detyrat e tyre të mëdha.”

(GS 47)

plotësohet seksualiteti njerëzor. Shkencat sociale të shekullit të fundit kanë konfirmuar se nuk ka shoqëri pa familje. Fuqia e familjes është e madhe: asnjë nuk mund të shkëputet prej saj. Ajo është si një rrjet i padukshëm, në të cilin të gjithë janë të lidhur me fije të padukshme me njëri-tjetrin. Ajo është në gjendje edhe të shkatërrojë njerëz, por kur arrin të krijojë një ekuilibër mes qëndrimit më pranë apo më larg mes anëtarëve të saj, familja mund të jetë edhe një vatër e sigurt që u jep anëtarëve të saj strehë dhe ngrohtësi. Në të vërtetë, të gjitha përshkrimet e sotme të familjes tregojnë se ajo është e pandashme me gjetjet dhe dhëniet e kuptimit të ekzistencës njerëzore, veçanërisht me ato kuptimdhënie që rrjedhin nga feja dhe besimi.

Mënyra e krishterë e veprimtimit që nga fillimi është e lidhur kulturualisht, por nuk është thjesht identike me kulturën e kohës dhe nuk shërret në të. Në këtë mënyrë i qaset edhe fenomenet të familjes. Fjala është se cili ndikim i përket porosisë së Jezu Krishtit, përkatësisht fesë së krishterë në konceptimin e martesës dhe familjes së krishterë. Meqenëse kjo ecuri nuk do të mund të qëndronte pa ndikim në institucione, Kisha i shtron vetes

pyetjen e arsyeshme, se a janë duke lejuar të njihen ndërkohë elementet bazë të strukturës së martesës dhe familjes, prej të cilave duhet qenë i sajuar (vetë) kuptimi i familjes, nëse duhet të karakterizohet si i krishterë. Në këtë kuptim martesë monogame (e lidhur vetëm me një partner – burrë/grua) është një element bazë i familjes në kuptimin e krishterë.

Zoti njerëzit e parë i krijoi mashkull e femër duke u dëftuar kështu identitetin dhe misionin e tyre dhe nga këtu edhe aftësinë e përgjegjësisë për dashuri dhe

këtë bashkësi, i përshëndesin sinqerisht të gjitha ato ndihma të ndryshme, me anën e të cilave bëhet përparimi i kësaj bashkësie të dashurisë dhe merret në mbrojtje jeta dhe bashkëshortëve dhe prindërve u japin mbështetje në detyrat e tyre të mëdha” (GS 47).

Familja ka rol të rëndësishëm ndërmjetësues mes individit dhe shoqërisë. Njëanshmëritë në drejtim individualist apo kolektivist, mund të jenë ndikime shumë të padëshirueshme për zhvillimin personal dhe institucional. Fjala është për një marrëdhënie të drejtë-peshuar dhe që kërkon gjithmonë drejtpeshim mes vetëpërkufizimit individual të njeriut dhe rregullave institucionale të kulturës shoqërore. Funksionet ndërm-

jetësuese të familjes së themeluar në partneritet personal dhe angazhimet për formimin e mjedisit familjar duhet të krijojnë kur kemi të bëjmë me familjen, ka shkaqe të ndryshme.

Shkaqet e problematizimit të jetës familjare

Fakti që marrëdhëniet jetësore të përbashkëta shpesh herë po përjetojnë si problem, veçanërisht kur kemi të bëjmë me familjen, ka shkaqe të ndryshme.

- Shumë familjarë personalisht po përjetojnë „ndryshime” glabëruese në jetën e tyre. Ata gjithnjë e më shumë i krahasojnë format e tanishme të jetës me jetën e familjes së brezit të mëparshme shpesh herë të paraqitura idealist; Përherë ka pasur dhe do të ketë problem me breza: pamundësia e bashkëbisedimit, shikimi i dukurive të njëjta nga këndvështrime të ndryshme, pandjeshmëria për ndjenjat e të tjerëve, kritika ndaj sjelljes dhe besimi i tjetrit;
- Lajmet mbi ndryshimet shoqërore, siç paraqiten për shembull nëpërmjet të të dhënave statistikore, ulja e lindjeve apo rritja e numrit të divorceve apo zvogëlimi i numrit të anëtarëve dhe mirëqenies

familjare, po bëhen të njohura dhe po diskutohen në opinion. Temat më të shpeshta që shkaktojnë mungesë harmonie ndërmjet brezave janë politika, pushteti, sjellja seksuale dhe feja. Disa mendojnë se konflikti ndërmjet brezave ndodh në përgjithësi për shkak të temave të tanishme, aktuale, kurse në raste të rralla për sa i përket shpjegimit të së kaluarës;

- Shumë familjarë ndeshin vështirësi në zbatimin e detyrave në familje. Kjo mund të jetë e kushtëzuar si nga marrëdhëniet, gjendja aktuale sociale, po ashtu edhe nga kuptimi ekzistues familjar dhe shoqëror i detyrave, respektivisht i të drejtave dhe detyrave personale. Para së gjithash, si pasojë e ndryshimeve të përgjithshme shoqërore (kriza ekonomike, ndryshimet teknologjike) lindin probleme, të cilat konsiderohen kryesisht si të vështira.
- Një problem i veçantë është roli i dyfishtë i anëtarit të rritur të familjes shumëbrezore. Kjo është njëkohësisht edhe burim i shumë konflikteve dhe mosmarrëveshjeve. Një person i tillë i rritur duhet njëkohësisht të jetë fëmijë i prindërve të vet dhe prind i fëmijëve të vet. Këto dy role vështirë po bashkohen sot në praktikë.
- Ihttarët për promovimin e fuqishëm për zhvillimin dhe pjekurinë e personalitetit që nga koha e iluminizimit në shumë vende bien në kundërshtim me vlerësimin e lartë të „institucionit” familje.

Disa dukuri të dinamikës brendafamiljare shqiptare

Jeta e brendshme familjare është rrjet i dokeve, përshatjeve, kompromiseve, marrëdhënieve emocionale, acarimeve dhe antipative, prej të cilave njeriu ushqehet dhe që më pas reflektohen brenda dhe jashtë saj. Në çdo familje mund të gjejmë një spektër të tërë sjelljesh njerëzore që e lehtëson apo vështirëson jetën e përbashkët.

Këtu do t'i cekim edhe disa dukuri të tjera që ndërlidhen me familjen shqiptare. Konsiderojmë se njëri prej problemeve

sfidave të kohës

të mëdha të familjes bashkëkohore, sidomos në dinamikën brendafamiljare shqiptare, është problemi i komunikimit. Të komunikosh do të thotë të marrësh dhe të japësh: të jesh i kuptuar dhe të dëgjosh përgjigjen. Arti i komunikimit fillon qysh në djep, në përgjigjen e nënës kur fëmija fillon të qajë. E pra, ajo që disa prindër nuk munden ose nuk dëshirojnë ta kuptojnë, qëndron në faktin se, meqë fëmijët rriten, komunikimi bëhet gjithnjë e më personal, më i baraspeshuar. Edhe prindërit duhet të mësojnë prej fëmijëve. Përpara, në përgjithësi, është folur për ndikimin e prindërve tek fëmijët; sot gjithnjë e më shumë po flitet edhe për ndikimin e fëmijëve tek prindërit.

Duhet pasur para sysh edhe dukurinë kur dy njerëz themelojnë një familje, edhe njëri edhe tjetri sjell programin e vet të ideve. Tani ato duhet të zhvillohen në idetë e përbashkëta që rëndom janë kompromis. Vështirësitë lindin kur njëri partner ose tjetri u qëndrojnë rreptësisht besnikë ideve të përvetësuara në familjen nga e cila rrjedhin. Fëmija që jeton dhe rritet në një program të tillë të dyzuar të ideve, është në konflikt të vazhdueshëm. Kjo mund të shpjegojë edhe të vërtetën përse hasim sot në shumë fëmijë me depresion.

Disa mendojnë se në familjen (post)moderne kufijtë janë zgjeruar për të favorizuar një kontakt më të ngushtë emocional dhe një klimë familjare më të qetë, në të cilën dhe fëmijët, që në moshë shumë të vogël mund të shprehin opinionet e tyre dhe të drejtojnë vetë autonominë e tyre, duke marrë pjesë në organizimin e familjes dhe në vendimet që merren brenda saj.

Të veprosh në ndryshim

Cilat do të mund të ishin ata hapat e vegjël, por të sigurt për t'u ballafaquar në mënyrë të përshtatshme me gjendjen familjare siç po e përjeton ajo shqiptare – kosovare? Mjeku iraniano-gjerman, Nossrat Peseschkian, themelues i të ashtuquajturës terapi pozitive familjare, kësaj pyetjeje do t'i përgjigjej me një fjalë të urtë lindore: "Dëgjo, o pemë, po ta kishe ndërruar me kohë vendin, nuk do të të duhej ta duroje as vrazhdësinë e sëpatës as mprehtësinë e sharrës!"

Një ndër shenjat tipike të çrregullimeve shpirtërore, psikosomatike dhe psikosociale është njëanësia e ideve dhe mbështetja e tyre me këmbëngulje. Idetë vetjake mbrohen me forcë, sepse heqja dorë prej tyre do të thoshte

rrezik për identitetin. Kjo veçanërisht vlen kur janë të kërcënuara konceptet që qëndrojnë në prapavijën e kuptimit të baraspeshës familjare. Në atë rast tregohet paaftësia e përshtatjes, d.m.th. e heqjes dorë nga idetë.

Paaftësinë e përshtatjes dhe tërheqjen në sistemin vetjak dr. Peseschkian e ilustron me të dhënat nga psikologjia e kafshëve. Thotë se në goftë se koteleve gjatë javëve të para të jetës u lejohet të shikojnë vetëm vijat horizontale ose vetëm të pjerrëta, bëhen "të verbëta" për mundësi të tjera. Kështu, kotelet "horizontale" e humbasin krejtësisht orientimin në botën me vijat e pjerrëta dhe anasjelltas. Ky eksperiment mund të krahasohet me situatën e njeriut që është rritur me një model të caktuar idesh dhe konceptesh. I mësuar në familjen e vet të sillet sipas një modeli të mirësijlljes, vështirë e gjen veten në një botë ku doket dhe zakonet janë të ndryshme nga të tijat.

Psikoterapisti Pavao Brajsa pohon se hapi i parë i një ndryshimi të njëmendtë të familjes fillon te vetë anëtarët e saj, nga prindërit dhe në komunikimin e tyre bashkëshortor. Për ta bërë jetën familjare më cilësore, më njerëzore, më të kënaqshme dhe më të lumtur dhe në këtë mënyrë të parandalohen pasoja të dëmshme, duhet që në familje të ndryshohet komunikimi personal ndaj vetes, bashkëshortit dhe ndaj vetë komunikimit familjar. Ta ndryshosh veten, bash-

“Njëri prej problemeve të mëdha të familjes bashkëkohore, sidomos në dinamikën brendafamiljare shqiptare, është problemi i komunikimit. Të komunikosh do të thotë të marrësh dhe të japësh: të jesh i kuptuar dhe të dëgjosh përgjigjen. Arti i komunikimit fillon qysh në djep, në përgjigjen e nënës kur fëmija fillon të qajë. E pra, ajo që disa prindër nuk munden ose nuk dëshirojnë ta kuptojnë, qëndron në faktin se, meqë fëmijët rriten, komunikimi bëhet gjithnjë e më personal, më i baraspeshuar. Edhe prindërit duhet të mësojnë prej fëmijëve. Përpara, në përgjithësi, është folur për ndikimin e prindërve tek fëmijët; sot gjithnjë e më shumë po flitet edhe për ndikimin e fëmijëve tek prindërit.”

këshortin, martesën dhe familjen është e pamundur. Së paku jo drejtpërdrejt. Por, të ndryshosh komunikimin/raportin tënd me veten, bashkëshortin, martesën dhe familjen është e mundur dhe madje e zbatueshme. Sa herë kemi thënë dhe kemi premtuar se do të përmirësohemi, por kemi mbetur të njëjtët madje



Familja e bashkuar

jemi bërë edhe më të këqij?

Për t'i ruajtur marrëdhëniet familjare, nevojitet të bisedohet për çështjet thelbësore të komunikimit/raportit ndërmjet anëtarëve, prindërit ta pranojnë realitetin e dyfishtë të partnerit në komunikim, mirëpo edhe barasvlefshmërinë e plotë në të. Biseda për komunikimin bashkëshortor është kushti pa të

pak nga pak po e humbet fuqinë e vet të ndikimit në çift. Në shekullin XXI mund të mbijetojnë vetëm familjet cilësore dhe të kultivuara.

Psikologu Mihaly Szentmartoni (Mihalj Sentmartoni) pohon se një proces terapeutik shkon kah lëkundja e ideve dhe koncepteve të tilla të ngurta dhe gjetja e mundësive të tjera. Teknika ka të bëjë me "ndryshimin e pikëpamjes", që arrihet me ndriçimin e ideve. Është fjala, pra, për një lloj terapie të njohjes. Kjo do të thotë se përpigjet të kuptohet *relativiteti* i koncepteve, ideve, gjykimëve vlerësues, dhe që koncepti i kundërt nuk do të thotë domosdoshmërisht rrezik, por zgjerim i horizontit vetjak. Kjo mundëson ripërkufizimin e situatës dhe zbulimin e zgjedhjeve alternative. Nuk është qëllimi i terapeutit të thyjë në mënyrë autoritare konceptet e ngrira dhe të ofrojë po mundësi të ngrira, por që t'i ndihmojë personit ta kuptojë cila ide e udhëheq, kah e shpie dhe çfarë mitologjie qëndron në prapavijë. Natyrisht, heqja dorë nga bindjet, doket dhe zakonet e forta të mëparshme mund të çojë në një trazim madje edhe të identitetit vetjak. Prandaj kjo nuk bëhet vullshëm, por gradualisht. Autori sërish propozon një urtësi lindore. Zakonet e vjetra nuk duhet thjesht të hidhen tej, por, si një mysafir i ri, duhet përcjell deri te dera. Urtia është ajo që

nuk vlen vetëm për Lindjen por edhe për Perëndimin, dhe jo vetëm për jetën familjare, por për çdo fushë të jetës së njeriut: nuk duhet me forcë të ngjitesh për asgjë që nuk është Absolute, sepse ndryshimi i kohës do të na shkelë me palëkundshmërinë e ideve të reja dhe formave të reja. Nuk mund t'i shmangemi përshypjes se edhe këtu realizohet porosia e biblës mbi idhujt: gjithçka që nuk është Hyj, që njeriu e absolutizon, i përket botës së idhujve. Kurse idhujt të bëjnë të palumtur – kjo vlen edhe për jetën familjare.

Kuptimi qëndror i përfytyrimit të familjes së krishterë është se Zoti është pranë njeriut jo vetëm në vendet dhe mbledhjet e veçanta kishtarë, por mu në mes të jetës së përditshme, në rrëmujën e përditshme të mosmarrëveshjeve familjare dhe të jetës së përbashkët, pikërisht aty ndodh shërimi dhe shpëtimi që jep Zoti. Hyji e krijoi njeriun në përngjasimin e vet. Në planin e Hyjit-Krijues edhe familja e gjen identitetin dhe misionin e saj. Ajo duhet të edukohet për të formuar bashkësinë e personave; të solidarizohet dhe jo të izolohej; të marrë pjesë në zhvillimin e shoqërisë; t'i shërbejë jetës; të falënderojë dhe jo t'i marrë gjërat si të vetëkuptueshme; t'i (ri)kuptojë, t'i përditësojë dhe jo t'i shtyjë/t'i harrojë gjërat; të marrë pjesë në jetën dhe misionin e Kishës.



Në gjitha varrezat e krishtera nëpër Kosovë ishin këto qirinj, burra e gra, fëmijë e të rritur, që në heshtje tuboheshin në varret tuaj. Janë këto çaste kur të gjallët sikur bashkohen me të vdekurët, me lutje e heshtje. Moria e njerëzve nëpër varret dhe shpirtit të lutjes dhe të shpresës për jetën e pasosur në Jezu Krishtin.

Ditën e parë dhe të dytë të nëntorit, varret e të krishterëve dekorohen në mënyrë të veçantë me krizantema dhe ndizen qirinj. Janë ditë të shënuara, në të cilat përkujtohen të vdekurët që kanë kaluar nga kjo jetë. Atyre u kushtohet kujtimi ynë, nderimi dhe lutja jonë dhe e Tij.

■ SHKRUAN:
Don Fatmir KOLIQI

Kalendari liturgjik i Kishës Katolike me 2 nëntor përkujton *Ditën e besimtarëve të vdekur*, *Ditën e shpirtit të Purgatorit* apo edhe *Ditën e të Shumëve*. Një mënyrë e veçantë kjo ditë i bashkon të gjallët në vendpushimin e të vdekurve (varret), "eshtrat" e të cilëve në qetësi presin për t'u shndërruar në jetën e re, për t'u ringjallur në Zotëriun e tyre, Jezu Krishtin.

Besimtarët i vizitojnë varret, i dekorojnë, sjellin atje buqeta lulësh, krizantema e qirinj për t'i nderuar. Kështu, të përgendruar në kujtimin e të dashurve të tyre, lusin për ta Zotin, që ai të jetë

i mëshirshëm e t'i pranojë në Mbretërinë e tij në qiell.

Varret këto ditë i bashkojnë të gjallët, besimtarë e jo besimtarë, të pasur e të varfër, pushtetarë e njerëz të thjeshtë. Sikur të vdekurit i bashkojnë të gjallët; sikur fakti i përkohësisë i bashkon për një çast të gjithë dhe i liron nga intrigat e pakuptimit, armiqësitë, ndarjet e përçarjet. Aty pranë varreve, të heshtur, të gjithë e shijojnë faktin e të mosqenit të përjetshëm në botë.

Dita e Purgatorit na vetëdijëson për vdekësinë tonë, tejkalon iluzionin e njeriut për përjetshmërinë në tokë. Njashtu është


thirrje për ta kuptuar jetën në tërësinë e saj, që ajo të planifikohet me urre. *Është i urtë ai që vdekja nuk e befason.* Ai që rron duke e pranuar ligjin e vdekjes, ai vërtet jeton. Sepse të jetosh do të thotë edhe të vdesësh. Për të përkujtuar këtë njëmendësi njerëzore, rregulltarët trapistë morën si përshëndetje të përditshme thënien: *Memento mori – kujto vdekjen!*

Historia

Dita e Purgatorit si përkujtim në Kishë, lidhet ngusht me festën e të Gjithë Shenjtëve. Në traditën e krishterë që në shek. IV krem-

tohet *Dita në kujtim të martirëve të shenjtë*. Papa Gregori IV, në vitin 835 e caktoi 1 nëntorin Ditë e të Gjithë Shenjtëve për të gjithë Kishën Katolike. Pasi Kisha i kremton me një ditë të gjithë shenjtërit, ata që e gëzojnë praninë e Zotit në qiell, ajo po ashtu do t'i kujtojë edhe ata që nuk janë të shpallur shenjtë, ata që ende nuk e gëzojnë lumninë e Hyjit, përkatësisht ata që mund të jenë në Purgator, në gjendjen e pritjes për të fituar jetën e pasosur. Kisha si Nënë e mirë, dëshiron t'i dalë në ndihmesë asaj kishë në Purgator, kishës në pritje për shëlbim. Shën Odili, abat benedik-

tin nga Cluny, më 998 kishte caktuar që 2 nëntori të jetë në abacinë e vet ditë përkujtimi për të gjithë besimtarët e vdekur. Kjo u vendos edhe në të gjitha abacitë benediktine të Evropës, që e kishin një ndikimin të madh të abacisë së Cluny-it. Kjo do nënkuptuar shtrirjen në një pjesë të madhe të Evropës, ku ishin abacitë benediktine. Pas një praktike të tillë që u tregua shumë e dobishme për kishën, në vitin 1311 pranohet edhe nga Selia e Shenjtë për të qenë ditë e shënuar në kalendarin liturgjik të Kishës, si ditë e posaçme kur përkujtohen të gjithë besimtarët që kanë kalu-



*ditë të mbushura me njerëz, pleq e të
shin rreth varreve të të dashurve të
vdekurit përmes kujtimeve të paha-
e, kudo nëpër botë, është shfaqje e fesë,
Hyjnin e Gjallë.*

*të veçantë me lule të bukura,
vdekurit, të dashurit tanë që
prejtuar Zotit që ata të prehen në*

Në varret e Prizrent,
Ditën e Purgatorit



NDËR VORRE

Po shkoj sot ndër vorre, Jezus,
s'është vend i këndshëm, e di,
më rrëqeth ky vend i heshtur,
ky vend ku ka veç zi.

Po shkoj për njerëzit që më deshën,
që ishin, por që shkuan,
po shkoj t'u shpreh mirënjohjen
për gjithçka më dhuruan.

Po shkoj t'ua pëshpërit shpresën time.
Po shkoj t'u pëshpërit se besoj,
në atë jetë mbi të cilën vdekja
askurrë nuk triumfoi.

Po shkoj t'u çoj një lule
simbol bukurie që duhet.
Po shkoj të ndez një qiri
simbol i zjarrit që s'shuhet.

Po shkoj të prek një fytyrë
mes kryqeve pa fund,
po shkoj të takoj Ty,
Jezus që vdekjen mund.



ar nga kjo jetë "në shenjë të fesë".
Që atëherë besimtarët e krishterë,
një ditë pas Të Gjithë Shenjtërve,
i përkujtojnë të dashurit e tyre të
vdekur, në lutje, në takime eukari-
stike për të përgjyruar tek Zoti
për shpirtat e tyre.

Kjo ditë, mund të thuhet me
plotë kuptimin e fjalës, është
edhe një ditë e fesë së besimtarëve
në Ringjallje, se jeta nuk mbaron
me vdekjen, por ajo shndërrohet,
ashtu si na ka premtuar Zoti ynë
Jezu Krishti.

Nderimin e të vdekurve dhe
lutjen për shpirtat e tyre e gje-
jmë qysh në Besëlidhjen e Vjetër
te Libri i Makabejve, kur Juda

Makabë kushtoi fli për shpirt-
trat e të vrarëve: "E si i mblodhi
nga secili burrë dy mijë dramba të
argjendta, i dërgoi në Jerusalem të
kushtohet flitja për mëkatë duke ve-
pruar kështu shumë mirë e bujar-
isht, i shtyrë nga mendimi i ring-
jalljes. E, njëmend, po të mos kishte
shpresuar se do të ngjallen ata që
u vranë, do të kishte qenë e tepërt
dhe e kotë të luteshin për të vdekur.
Pastaj ai e kishte parasysh se një
shpërbim tepër i bukur i priste ata
që vdesin në birin e Zotit: mendim
ky i shenjtë e i përsëritshëm. Ja,
pra, dha të kushtohet fli shpërbimi,
që të çlirohen nga mëkati." (2 Mak
12, 43).

Halloween – Nata e shtrigave?

Në disa shtete të Evropës Perëndimore dhe në SHBA, e, kohën e fundit, edhe në vendin tonë, më
31 tetor festohet Nata e shtrigave apo Halloween. Ka shumë njerëz që këtë festë pagane e lidhin
me Ditën e të Gjithë Shenjtërve, por ajo nuk ka kurrfarë lidhje me festën e Kishës Katolike të Gjithë
Shenjtërve as me Ditën e Purgatorit. Vërtet, vetë fjala Halloween është përfitim nga kombinimi i
fjalës angleze All Hallows Eve apo All Hallows Day (apo edhe All Saints Day), që me këtë emërtim
anglistfolësit katolik e quajnë Ditën e Gjithë Shenjtërve.

Por vetë festa është pagane, që ka prejardhjen prej fisit Gal e Kelt të Irlandës dhe Britanisë veri-
ore. Origjina e Halloween e ka burimin në "Samhain" – zoti i të vdekurve, kur keltët natën e 31
tetorit shënjonin fundin e vitit dhe fillimin e një viti të ri.

Keltët i frikoheshin kësaj nate, i frikoheshin "samhain-it" dhe, në mënyrë që ta kënaqnin atë,
Druidistet (priftërinjtë kelt) bënin rite trishtuese me zjarr të madh e sakrifica si nderim ndaj tij.
Ata i digjin të gjallë kriminelët, të burgosurit dhe kafshët. Derisa i vështronin ata duke u djegur,
druidistet shihnin shenja për të ardhmen, të mira e të këqija. Druidistet i besonin shumë kësaj nate,
sepse mendonin se shpirtat ishin më të fuqishëm dhe më të egjër dhe u lejohej të bridhnin të
lirë dhe nëse ata ishin të trajtuar mirë, atëherë ata do t'i ndihmonin druidistet që të parashohin të
ardhmen. Nëse shpirtat i injoronin, atëherë ata do t'i dënonin keltët. Druidistet besonin se përvëç
shpirtave të fuqishëm e mizorë, kishte edhe të këqij. Kjo është arsyeja pse populli kelt vishte ko-
stume qatë festës së samhain-it. Qëllimi i kostumeve ishte që t'i frikësonin shpirtat e këqij dhe



Mons. Damjan Kurti

Cka keni punuar në Velezhë?

Mons. Damjani: Çka s'kam punuar? Puna më e madhe ishte në pastoral, pastaj kam ndërtuar shtëpinë aty. Kemi ndërtuar në Sallagrazhdë kishën e re e një kapelë në Sërbicë. Puna më e madhe ishte për të nxjerrë seminaristë nga ai vend, sepse në atë kohë kishte mungesë të klerit. Në famulli kishim grupet e rinisë, e në mesin e tyre që ishin më të përshtatshëm, më të zellshëm e më të mirë, i afroja dhe u kush-toja më shumë kohë për t'i përgatitur për seminar. Në klasën e tetë gjatë katekizmit u jepja nxënësve një letër në formë të pyetjeve se çka do të bëni në jetën tuaj të mëvonshme. Kishte prej tyre që shkruanin se dëshirojnë të bëhen prift. Prandaj, bisedoja me ta. Një numër i madh i tyre kanë shkuar në seminar, e disa prej tyre sot janë meshtarë. Dikur për një kohë të gjatë kam qenë edhe përgjegjës për seminaristët e Ipeshkvisë sonë. Shkoja në Subotić e në vende të tjera ku ishin, i vizitoja, kujdesesha për ta. Kryesisht seminaristët ishin në Zagreb, në Kaptol dhe të jezuitët dhe në Rijekë. Po ashtu gjatë kohës së verës, derisa seminaristët ishin në pushim, rinim bashkë, luteshim bashkë e në këtë formë i kisha parasysh e kujdesesha për ta. Ka pasur raste që i kam vizituar edhe kur ishin në shërbimin ushtarak.

Diçka tjetër për punën tuaj pastorale në atë kohë, kur ishte koha e komunizmit?

Mons. Damjani: Po, kishte vështirësi, kur kërkonin lejen për ndërtimin e Kishës në Sallagrazhdë, ata nuk lejonin. Ne kërkonim një leje kinse për një kapele për të vdekur. Kishte probleme të natyrës së ndryshme, në veçanti në lidhje me kurorëzimet, por i tejkalonim disi. Shpesh besimtarët siguronin dokumente të rregulluara, por i tejkaloja ato gjëra, nuk i lejoja të jetonin në mëkat. Si çelës të suksesit me besimtarët kam pasur parimin: "mos ia prish as gëzimin as bidhërimin". Kishte edhe raste të atilla kur besimtarët nga

frika e pushtetit nuk guxonin të vinin në kishë për të vu kurorë, e ka ndodhë që kam shkuar edhe në shtëpitë e tyre dhe i kam kurorëzuar. Por në përgjithësi, kam punuar ashtu që sa më shumë njerëzve t'ua plotësoj dëshirat e të jem afër tyre. Gjithmonë isha afër tyre, në të gjitha situatat, e në veçanti kur kishin probleme të ndryshme.

Ju keni punuar edhe për shumë pajtimet dhe faljen e gjaqeve?

Mons. Damjani: Në këtë fushë kemi pasur edhe këshillat nëpër fshatra, që kanë pasur për detyrë ta lajmërojnë kishën, kur kishte ndonjë problem ose ndonjë ngatërresë, kështu që kemi marrë masa ende derisa ka qenë problem i vogël për mos me mbërritje të mëtejshme. Nëse ka mbërritje të mëtejshme, është dashur punë shumë e madhe për t'i gjetur njerëzit e afërt të tyre, për t'i lutur që të falin dhe që të më jenë krah në atë punë. Ata e përgatitin terrenin. E kam pasur një rast të pajtimeve me Ndue Sokolin. Ky ishte i pafaj, ishte prej Sallagrazhdë, dhe një komshi kishte sulmuar atë të pafajshëm, ndërsa fajin ndoshta e kishte një i afërt i tij. Ishte një punë mjaft e rëndë, por i them Ndout, me ta sjellë atë që të ka sulmuar me duar të lidhura, a do ta falësh? Unë i them atij komshisë së duhesh ardhur duar lidhur te Ndue Sokoli për me të falur, e ai pranoi. Më tha: Zotëri po të ma ngarkosh edhe malin mbi shpinë, për ty do ta bart. Nuk kisha me çka t'ia lidhja duart, ishte dimër dhe e mora shallin tim e me atë ia lidha e shkuam vonë në mbrëmje të shtëpia e Ndue Sokolit. Në punë si këto më kanë ndihmuar shumë burra në atë kohë, në mesin e tyre ishte edhe Gjokë Spaçi, ai i njihte njerëzit dhe më këshillonte. Shkonim edhe ne mesin e myslimanëve për ndonjë ndihmë.

Në kohën tuaj në fillim në Kosovë kishte shumë pak meshtarë?

Mons. Damjani: Po, problemi më i madh në atë kohë për kishën ishte mungesa e meshtarëve.

Por nuk ishte vështirë të punohej me një popull si ai që ne e kishim, një popull i mirë, besnik e besimtarë të mirë. Shpesh ju them edhe priftërinjë këtu në Shqipëri: famullia duhet të jetë një mini seminar, famullitari të punojë pak më shumë me ata që janë më inteligjentë, sepse thirrjet nuk zbresin nga qielli. Duhet të punohet me ta, e pastaj edhe Zoti e kryen pjesën e vet.

Në atë kohë, siç të thashë, ndjehej mungesë e madhe e meshtarëve, e ipeshkvi i atëherëshëm, Smiljan Çekada, e bëri njet për thirrje të shkonte këmbë në Letnicë te Shenjtorja Zojë Cernagore. Kështu për rresht shtatë vjet. Një vit, më kujtohet, isha i ri, e Don Luka Cirimotiq më porositi t'i them ipeshkvit që nëse mendon të vijë në Letnicë, të nisat herët nga Shkupi, sepse bën vapë. E ai më përgjigjet, se këtë rrugë e bëj për pendesë e sakrificë për thirrje të reja meshtarake. E ashtu erdhi deri në Gërllicë, e pastaj i zbatih këpuçit e çorapët e filloi këmbë zbatuar të udhëtojë. Në atë kohë rruga nuk ishte e asfaltuar. Eci deri në Kabash, e kur mbërritëm aty ipeshkvi ra për tokë, s'mundi më. Ne i gjetëm një kali deri në Binçë, e aty motra Otilia deshi t'ia lajë këmbët e t'ia pastrojë plagët, por nuk e lejoi. Mori vetë pak alkoool dhe i pastroi, pastaj arriti Don Gaspri me makinë dhe e çoi deri në Letnicë. Viteve tjera nisej prej Vitisë këmbë, dhe barte një litar rreth qafës në shenjë pendese. Kështu ka zgjatur shtatë vjet. Na thoshte, këtë pendesë e bëj për ju që jeni në seminar, që të qëndroni e të na vijin edhe të tjerë. Pra, bashkëpunimi i ipeshkvit me meshtarë është i domosdoshëm, por nevojitet edhe lutja e sakrifica.

Pse s'kemi pasur thirrje e kaq popull besnik?

Mons. Damjani: Përgjigja është e thjeshtë, nuk kemi pasur shkollat, ato kanë qenë vetëm nëpër qytete. S'ishte mundësia që pa aspak shkollë t'i çojmë në seminare, edhe pse populli ishte shumë i mirë. Kur filluan shkollat, filluan edhe thirrjet, kupto-

Intervistë me Mons. Damjan Kurtin – me rastin e 70 vjetorit të lindjes

Famullia duh

het në bashkëpunim të ngushtë me famullitarët. Për shembull, në kohën e Don Dedë Ramaj, kishte thirrje, gjenerata e Don Lushit e Don Ndout, por s'kishte shkollë aty, duhej të shkonin në Zhegër, është dashur në ora 5 të mëngjesit të nisen për të arritur me kohë në mësim.

Në vitin 1991 keni ardhur këtu në Durrës?

Mons. Damjani: Isha në pushime me seminaristët diku në Budvë, më thërrret në telefon Don Mark Sopi. Atë e kishte kontaktuar një kardinal dhe e kishte lutur të shkonim në Shqipëri.

Ende ishte fillimi, e disa pjesë sado kudo kishin ndonjë meshtarë, por zona e Durrësit nuk kishte asnjë, dhe sapo erdhëm në të gjitha anët na thirrshin besimtarët t'i hapim kishat. I kemi hapur prej këtu deri në Rubik. Ishte një punë shumë e rëndë. Edhe sot është shumë vështirë, sepse njerëzit lëvizin shumë, këta nga Durrësi shkojnë për Itali, ata nga zonat malore vijnë këtu, e kështu asesi të përfundohen pagëzimet e të rriturve, vazhdimisht rrjedhin si një lum. Për shembull, një regjistër të besimtarëve që e kemi bërë dikur, më ai nuk vlen, sepse komplet popullata është ndërruar. Por në përgjithësi është pak më lehtë sepse ka meshtarë më shumë edhe pse është një numër i konsiderueshëm i besimtarëve, mendoj mbi dhjetë mijë janë katolikë. Por jetojnë në kushte shumë të vështira, një numër i madh jetojnë ende nëpër baraka. Edhe terreni këtu është i pa përshtatshëm, sepse dikur ishte moçalishte, e kur Enveri i hapi kanalet mendoj t'i bëjë tokë buke, por kishte harruar se kur të ikën uji këtu mbetet kripa. Me të gjitha këto probleme ata drejtohen te kisha, mendojnë se kisha është çelësi i të gjitha problemeve të tyre.

Gjatë kohës së luftës në Kosovë ju keni pranuar shumë refugjatë?

Mons. Damjani: Këtu kemi pasur një qendër strehimi, ku

edhe i pranoni, e përreth Durrësit i kemi pasur pesë pika, e së bashku me shumë bashkëpunëtorë i kemi shërbyer mbi 80.000 refugjatë. Në fillim kemi vuajtur të gjithë së bashku për ushqim, derisa nuk erdhën organizatat e huaja, e pastaj ata i morën punët në dorë. Sot shumë njerëz nga Kosova që i takoj, flasin me admirim për Durrësin. Këtu, te kisha, neve na kishin dhënë një tendë të madhe ushtarë italiane që të shërbente si shkollë, e ne mirë e dinim se Kosova ka nevojë edhe për lutje, e kështu atë tendë e bëmë edhe shkollë, edhe kishë edhe xhami. Aty bënim lutjet, nuk thoshim meshë, unë u lexoja edhe Biblën edhe Kuranin, i zgjidhnim pjesët më të bukura nga këto libra, bënim lutje spontane për ata që kishin mbetur në Kosovë. Kështu kemi pasur gati çdo ditë lutjet për Kosovën. Shumë të rinj më ndihmonin së bashku me disa mësues nga Ko-

Mons. Damjan Kurti, Mons. Nikollë Mini dhe Mons. Mark Sopi



Gjatë luftës në Kosovë në Durrës i kemi shërbyer, së bashku me shumë bashkëpunëtorë, mbi 80.000 refugjatë. E kishim një tendë të madhe që na kishin dhuruar ushtarët italianë, e cila shërbente si shkollë, e ne mirë e dinim se Kosova ka nevojë edhe për lutje, e kështu atë tendë e bëmë edhe shkollë, edhe kishë edhe xhami. Aty bënim lutjet, nuk thoshim meshë, unë u lexoja edhe Biblën edhe Kuranin, i zgjidhnim pjesët më të bukura nga këto libra, bënim lutje spontane për ata që kishin mbetur në Kosovë. Kështu kemi pasur gati çdo ditë lutjet për Kosovën.

et të jetë një mini-seminar

rishia. Këtu i kam pranuar edhe disa refugjatë të sapoqiluar nga burgu i Mitrovicës, edhe pse nuk kishim vend të mjaftueshëm, prej Mitrovice në bregdet, kjo ishte provania e Zotit! Ishte verë e kishin mundësi me u la në det, me pushu, e kështu sadopak me i harro ato brenga, ato mundime që i kishin përjetuar ata njerëz. Pra kisha katolike në përgjithësi, kudo nëpër Shqipëri e më gjerë, prej Shkodrës e deri në fund të Shqipërisë e kudo nëpër Kosovë ka dhënë një kontribut të madh në strehimin e njerëzve, grave, fëmijëve, pleqve e të gjithë atyre që kishin qenë të detyruar t'i braktisin trojet e shtëpitë e veta. E nga njëherë me dhemb zemra kur dëgjohet se kisha katolike nuk e ka dhënë kontributin e vet. Jo, kjo s'është e vërtetë. Kisha ka kontribuar mjaft, aq sa ka pasur mundësi e hapësirë. Të gjithë meshtarët, shqiptarë e të huaj misionar kemi bërë çmos

që tu dalin në ndihmë refugjatëve. Monsinjor Rrok Mirdita na pati urdhëruar që kishat t'i vejim në disponim të tyre për strehim. Nëse nuk keni ku t'i strehoni, strehoni nëpër Kisha, na pati urdhëruar ipeshkvi. E sot jemi krenarë për ndihmën që u kemi dhënë njerëzve që ishin në nevojë. Pra, këtij populli tragjik, kisha katolike ia ka dhënë ndihmën që askush tjetër s'ia ka dhënë.

Por megjithatë, ka shumë njerëz që me dashuri i kujtojnë ato ditë dhe shprehin falënderimin e tyre?

Mons. Damjani: Po, ka pasur shumë refugjatë që na janë falënderuar. Ishin të kënaqur me ne, e ne të kënaqur me ta. Për refugjatët katolikë jam kujdesur shumë, por për ata myslimanë edhe më shumë, që mos ta ndiejnë vetën keq ndoshta, kemi dhënë krejt çka kemi pasur,

vetëm që ta ndiejnë vetën si në shtëpinë e tyre. Kosova duhet të jetë gjithmonë falënderuese ndaj Shqipërisë e ndaj kishës këtu.

Bashkësia ndërkombëtare për refugjatë ju u ka shpërblyer me një shpërbllim të madh për gjitha punën e sakrificën tuaj?

Mons. Damjani: Gjatë asaj kohe kishte shumë organizata të huaja, nga shtete e kombe të ndryshme. Ata kanë parë punën time këtu e në fund të luftës kanë dashur ta falënderojnë dikë, ndonjë organizatë apo person.

Këshillë për Refugjatë e Kombeve të Bashkuara ishte njoftuar për punën tonë në Durrës, bile ishte edhe të monsinjor Rroku.

Derisa unë isha në një udhëtim në Gjermani më erdhi një ftesë nga ambasada e Zvicrës, ku më lajmëruan për shpërbllimin që ma ka ndarë Këshilli për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara. Shkova në Parlamentin zviceran dhe aty një zyrtar i lartë i Kombeve të Bashkuara ma ndan diplomën dhe një shpërbllim prej 50.000 franga zvicerane. Më pyetën çka do të bëja me ato para, u tregova se do t'i ndërtoj disa shtëpi të vogla këtu në Durrës, sepse e kisha një projekt që e quaja vetëndërtim, unë e bleja materialin, ndërsa banorët ndërtimin e bënin vet. Dhe nga këto mjete kam blerë material për dhjetë shtëpi të vogla që më vonë i kemi ndërtuar.

Ju një kohë e keni drejtuar edhe revistën Drita?

Mons. Damjani: Meritat më të mëdha i ka monsinjor Nikollë Mini, ai na ftoi të bashkohemi rreth tij për t'i dhënë njerëzve në dorë diçka të shkruar. Nuk ishim shumë meshtarë, por ata që ishim, u mblodhëm rreth tij. Unë isha më shumë i pasionuar me martirët e Stullës dhe të Binçës, më tepër shkruaja për ata. Edhe këtu në Shqipëri jam marrë me martirët, është dashur të mblidhen shumë dëshmi për ata, për procesin e beatifikimit të tyre. Kemi punuar rreth tri vjet, e tani jemi në përfundim të punës

sonë. Shumë nga shkrimet që i kemi bërë për martirët e Stullës e të Binçës në revistën Drita, si dhe disa dorëshkrime e burime të tjera, u kanë shërbyer shumë studentëve të teologjisë për punimet e tyre të diplomës.

Gjatë gjithë kohës sa ishit në Kosovë keni qenë të ngarkuar me kujdesin për seminaristët, tani edhe këtu u kanë ngarkuar me këtë detyrë?

Mons. Damjani: I kam tre priftërinj që janë prej Durrësit. Durrësi si qytet ka pak fëmijë. Këtu kishin pasur zakon që t'i kenë nga dy fëmijë. Unë punoja me fëmijët, kisha këtu një grup të rinjsh. E një ditë njëri më drejtohet: Monsinjor, a mund të bëhem unë prift? Po, me ndihmën e Zotit, po, mund të bëhesh. I tregova se duhet leja e prindërve etj. Nuk e njihja mirë, ai kishte qenë mysliman. E ditën tjetër erdhi me plotë gëzim, më tha: unë kam lejen e prindërve. Por unë i përgjigja se unë dua të flas me ta. Një mbrëmje shkova, por më vinte shumë rëndë t'i thosha. Në bisedë e sipër e pyeta prindin e tij se çka kishte punuar gjatë jetës. Më tregoi se kishte qenë oficer në ushtrinë e Enver Hoxhës. Kjo përgjigje më rëndoi edhe më shumë, se si t'i them për punën e djalit të tij. E pyeta, të ka thënë gjë çuni. Po, mu përgjigj, më ka thënë se dëshiron të bëhet prift. Po ti çka thua, e pyeta. Unë do të isha krenar po u bë çuni im prift, ma ktheu. Pastaj e pyeta të emën, po ti çka thua? Po, tha, çuni im zgjohet në gjysmë të natës e lutet. Pastaj u thashë se është shumë i vogël, shumë i ri. Le të shkojë në seminar, le ta kryejë gjimnazin e pastaj le të vendosë nga do të shkojë. Ata u pajtuan, e dërgova në seminar në Shkodër e pastaj kreu edhe fakultetin e sot është një prift i mirë. Është një thirrje e çuditshme, që më mahniti. Sot shërben në Tiranë. Është edhe një rast i bukur i një holandezi që shëtiste Evropën e deri në Jerusalem me këmbë e me biçikletë, kishte udhëtuar gjithkund. E pata takuar disa vite rresht këtu në Durrës. Më tregoi

që kishte kryer jurisprudencën, por nuk kishte pasur guximin të bëhet avokat apo gjykatës nga frika se do të gabonte në jetën e tij. Pas tri vitesh më pyeti: a më ndihmon të bëhem prift. I tregova ipeshkvit dhe ai e dërgoi në teologji. Edhe sot është prift në Tiranë. Edhe një rast: një njeri më thirri në fshatin e vet: eja. Mu duk sikur ai maqedonasi që e thërrret Shën Palin: eja tek ne. Por i thashë se tek ju nuk ka kishë. Mu përgjigj, shtëpia ime është kishë. Ajo shtëpi për kohë të gjatë na ka shërbyer si kishë, e në fund, djali i tij Gjergji, më tha se dëshiron të bëhet prift. Nëna e tij u brengos, por i thashë, më ftuat dhe shtëpinë tuaj e bëtë kishë, e tash Zoti po e thërrret djalin të bëhet prift. Edhe ky sot është një prift i mirë. Edhe Kosovës do t'i vijë koha të krijojë mini seminare. Mini seminar është famullia, puna e meshtarit me të rinj ku do të mblidhen të rinjtë për ta gjetur rrugën dhe ushqimin e shpirtit. Vendi ku njerëzit e gjejnë Zotin.

Intervistoi:
Pater Ndue Kajtazi, OFM

Shkurt...

Monsinjor Damjani u lind në vitin 1937, nga prindërit Gjergj e Gjyla. U pagëzua në ditën e Shën Damjanit. Seminarin/gjimnazin klasik e kreu në Pazin, ndërsa fakultetin filozofiko-teologjik në Zagreb. U shugurua meshtar në ditën e diel më 4 korrik të vitit 1965 në Prizren, nga Imzot Smiljan Çekada. Shërbimi i parë i tij ishte në Ferizaj, aty ku ishte edhe ipeshkëvia; kreu detyrën e sekretarit për tri vjet. Pastaj transferohet në famullinë e Velezhës deri më 1981. Nga viti 1991 shërben në famullinë e Durrësit, Arqipeshkvia Tiranë - Durrës. Është njëri ndër meshtarët e parë që shkoi në Shqipëri pas rënies së komunizmit



personalitet

Me figurën e tij u morën jo vetëm biografe e gjuhëtarë por edhe piktorë e skulptorë të ndryshëm. Kështu, figurën e Shën Jeronimit e pikturon vetë Leonardo da Vinçi. Njihen më shumë se 1500 portrete të Shën Jeronimit në historin e artit evropian.

Mbi origjinën ilire dhe veprimtarinë

■ Shkruan:

Prof. Dr. Jahja Drançolli dhe Gjon Berisha

Qëndrimet e Shën Jeronimit ndaj kulturës antike

Që në shek. II fillon diskutimi apo, më mirë të themi, polemika e hapët në mes mendimtarëve të krishterë rreth problemit të vlerave shpirtërore e kuptimore të filozofisë pagane. Problem thelbësor i polemikave do të jetë harmonizimi i botëkuptimeve të kundërta antike-pagane me atë të krishterë, të cilët apologetët e parë të krishterë, që për nga formimi intelektual ishin pjellë e kësaj filozofie pagane, përpiquan ta realizojnë, të paktën për sa i përket mënyrës së të shprehurit. Kjo shihet qartë në faktin se idetë e veta apologetike të krishtera i shprehnin në përkrah të menduarit filozofik helenistik.

Lidhur me qëndrimin ndaj kulturës antike në përgjithësi dhe veprave letrare e filozofike në veçanti, vend të posaçëm zë Shën Jeronimi. S'do mend se formimi i tij intelektual i lartë, ia mundësoi edhe njohjen e shkëlqyeshme të letërsisë, filozofisë dhe në përgjithësi të kulturës shpirtërore pagane. Si fëmijë, në Romë u njoh me mësimet e *Elus Donatit*, grammatikentit dhe komentatorit të veprave të Tarencit. Për mrekulli i njohi *Plautin*, *Tarencin*, *Lucrecin*, *Ciceronin*, *Salustin*, *Vergjilin*, *Horacin*, *Lukanin* etj. Njohja dhe ndikimi i tyre ndeshet në çdo faqe të veprave të tij. Ai, kur në moshë të shtyrë i kujtohet se sa vështirësi të mëdha kishte pasur të zotëronte hebraishten, ndër të tjera thotë, se shkaku i kësaj qëndron në faktin se ishte i mësur me "mëprehtësinë e mendimit të *Kuintilianit*, rrjedshmërinë e *Ciceronit*, dinjitetin e *Frontinit* dhe me butësinë e *Plinit*". Ndërkaq kur Magnusi e pyet pse i përdorur shumë shembujt nga letërsia pagane, ai me argumente të shumta flet për nevojën e tyre. Qëndrimin pozitiv ndaj kësaj letërsie e shohim edhe në letrën e tij të famshme dërguar *Paulin Nolanit*, e shkruar rreth vitit 395. Në këtë letrë jep udhëzime se si duhet të lexohet Shkrimi i Shenjtë ose Besëlidhja nga një anë dhe, nga ana tjetër flet në dobi të argumentit të lashtësisë

- prioritetit të vetë Biblës ndaj të menduarit shkencor pagan.

Nga kjo shihet qartë se për Shën Jeronimin kuptimi i Biblës nuk është i mundur pa njohjen e filozofisë dhe literaturës klasike. Këtë qëndrim e shpreh qartas në parathënien e *Kronikës* botërore të Euzebit të Cezaresë, që e përpunoi në sistemin tabelar, të përshkruar me shënime historikoletrare dhe u bë gurëthemel i *Kronikës së letërsisë historike* në të cilën do të përqendrohet pastaj *Izidori i Sevilës*.

Ilirët dhe Iliria të Shën Jeronimi

Për sa i përket të dhënave që na ofron Shën Jeronimi mbi ilirët dhe Ilirinë, ato janë të natyrave të ndryshme. Në to flitet për sulmet e gotëve dhe barbarëve të tjerë nga kapërcyelli i shek. IV, për shkatërrimet e plaçkitjet që pësojnë krahinat e ndryshme të Ballkanit, për përhapjen e krishterimit në këto hapësira; ai jep gjithashtu dhe njoftime të tjera me karakter gjeografik e administrativ.

Në të gjitha veprat e tij, madje edhe në letrat, ka të dhëna edhe për "vendlindim, ku kam lindur", shkruante Shën Jeronimi. Ai në shkrimet e veta përmend fakte të rralla, por shumë të rëndësishme për popullin e tij. Kështu në lidhje me gjuhën ilire thoshte: "[...] se ilirët deri në Perandorinë e vonshme (romake) flitnin ekskluzivisht në gjuhën e tyre [...]". Po ashtu me pietet fliste për birrën ilire të quajtur *sabatium* ose *sabaia* që e përdornin bashkë me një pije prej mjalti. Ndërsa në mitologji dhe në antropologji, legjenda e Shën Jeronimit e shënuar mbi jetën e Shën Hilarionit, i cilie mbytë gjarpurin Boas dhe i shpëton banorët e Epidaurit, është komentuar edhe nga pikëpamja shkencore nga *Ser Arthur J. Evans*, më vonë si personifikim i fitores së krishterimit ndaj besimit pagan, si lidhje e mitologjisë vendase me religjionin e ri.

Sipas studiuesit Z. Mirdita, rrënjët e historiografisë kishtarë shqiptare janë shumë të lashta. Ato lidhen me veprën e Shën Jeronimit "Mbi njerëzit e shquar".

Shën Jeronimi e rikonfirmon pohimin e Shën Palit dhe ofron dëshmi lidhur me përhapjen e krishterimit në Iliri në krye me këtë apostull, duke thënë: *In omnibus locis versabatur* [...] cum *Paulo in Illyrico* (U përhap në të gjitha vendet [...] me Palin në Ilirik).

Ndërkaq, lidhur me dyndjet e popujve barbarë dhe shkatërrimet, që përjetuan territoret ilire, Shën Jeronimi si dëshmitar, i përshkroi në *Epistolae* me fjalët: "më rrëqethet shtati kur mendoj të tregoj për shkatërrimet në kohën tonë. Në vrazhdim të njëzet vjetëve, bile edhe më tepër, gjaku romak derdhet për çdo ditë ndërmjet Konstantinopolit dhe alpeve Juli: goti, sarmatë, kuadi, alani, huni, vandalët dhe markomanët shkretojnë, plaçkitin dhe grabisin *Skythinë*, *Thrakinë*, *Maqedoninë*, *Dardaninë*, *Dakinë*, *Thesalinë*, *Ahenë*, *Epirin*, *Dalmatinë* dhe gjithë *Pannoninë*. Sa matrone (gra fisnike - red. J.D.-Gj.B.), sa virgjëresha kushtuar Zotit, sa njerëz të lirë dhe fisnike u dhunuan në këto lufta! U morën robër peskopë, u vranë presbiter dhe shërbyes të tjerë të ndryshëm të kishës. U shkatërruan kishat. Pranë altarit të Krishtit u vendosën si në grazhd, kuajt. Kockat e martirëve u nxorën nga varret. Kudo zi, kudo ofshe dhe pamje vdekje [...]". Më pas letra vazhdon lidhur me shkatërrimet që kishte pësuar vendlindja e tij: "[...] për këtë arsye [...] u detyruam të dërgojmë në atdheum tonë (Stridon të Dalmacisë - red. J.D.-Gj.B.) vëllain *Paulinianin*, që të shiste shëpëtë e vogla gjysmë të shkatërruara, të cilat u shpëtuan duarve të barbarëve, dhe pasurinë e prindërve tanë të përbashkët, në mënyrë që të mos t'u japim rast të qeshin smirëzëzëve dhe atyre që mendojnë keq, duke lënë pa kryer punën e shenjtë që kemi ndërmarrë [...]".

Gjithashtu në lidhje me sulmet e gotëve në veprën e tij *Comentarium in Sophonium prophetam* liber (Libër komentarësh për Sofonin profet) shkruante: "[...] kur shkatërrohen qytetet dhe vriten njerëzit, ikin dhe rrallohen edhe kafshët, zogjtë e peshqit. Për këtë është dëshmitar, Iliriku, dëshmitarë është *Thrakia*, dëshmitarë është

edhe vendi ku kam lindur, ku çdo gjë u zhduk përveç qiellit e tokës, gjembave që rriten dhe pyjeve të dendura". Në veprën e tij *De viris illustribus liber* (Liber mbi burrat e shquar), jep informata edhe për vetëvetën: "Unë, Hieronymi, biri i Eusebit, nga qyteti Stridon, i cili dikur gjendej në kufi në mes Dalmatisë dhe Panonisë dhe që u shkatërrua nga gotët deri në këtë vit [393] dhe pikërisht deri në të 14-in vit të sundimit të perandorit Teodos, shkrova këto vepra [...]".

Shën Jeronimi në relievet e skulptorit Ndre Aleksit

Jehona e Shën Jeronimit ka qenë e madhe në shekuj të ndryshëm. Jeta dhe veprimtaria e tij u bënë frymëzim për shumë studiues të ndryshëm. Me figurën e

tij u morën jo vetëm biografe e gjuhëtarë por edhe piktorë e skulptorë të ndryshëm. Kështu, figurën e Shën Jeronimit e pikturon vetë *Leonardo da Vinçi*. Njihen më shumë se 1500 portrete të Shën Jeronimit në historin e artit evropian. Disa figura relieve të Shën Jeronimit i ka realizuar edhe skulptori i madh arbëror i shek. XV *Ndre Aleks Durrësaku*, apo siç quhet ndryshe *Andreas Alexius Epirota Durachinus* (1425-1505).

Interesimi i Ndre Aleksit për figurën dhe relievet e Shën Jeronimit është rezultat i situatës së vështirë të viteve 30-të të shek. XV-të, në të cilën u gjend Arbëria dhe Dalmacia, pikërisht është fjala për kohën e rënies së Krujës nën turqit, kohë kjo kur ekspansioni turk arriti deri në dyert e Dalmacisë. Edhe Ndreu,



Pjesë nga Vulgata – botim i Stuttgartit

rinë e Shën Jeronimit (II)

sikur i ka ndie disa lidhje intime me Shën Jeronimin, me këtë bashkatdhetar të humbur në shkretëtirë, me këtë shkrimtar që me nostalgji e përkujtonte vendlindjen e vet, dhe sikur Ndreu këtë lidhshmëri të tij intime dëshironte ta muronte në gur me shumë inkarnime të figurës së Shën Jeronimit. Sot janë të njohura njëmbëdhjetë relieve të këtylla, kurse për të tjerat supozohet se gjithashtu janë vepër e oficinës së tij. Relievi e parë kushtuar Shën Jeronimit, Ndreu e punoi në Pagëzoren e tij të Trogirit, kurse njëzet vjet më vonë e ndërtoi përsëri relievin Shën Jeronimit për kishëzën e asketëve të Shën Jeres në Marian të Splitit. Edhe sot është e ruajtur kjo shpellë askete, në të cilën me shekuj kanë jetuar asketët

pranë kësaj kishëze mbi altarin e të cilit Andreu e ka ndërtuar relievin e vet me përkushtim dhe emrin e vet si dhurues (*Andreas lapicida*) dhe me shënimin e vitit 1480 si vit i dhuratës.

Përveç këtyre dy relieveve të sigurta ekzistojnë edhe i treti për të cilin mund të thuhet me siguri se është vepër e Ndreut ose e oficinës së tij. Relievi gjendet në Londër dhe dikur është menduar si vepër e skulptorit italian Pietro Lombardi. Më vonë është vetëtur nga studiuesi i arteve, C. Fiskoviq, se ky punim është vepër e oficinës së Ndreut. Siguria e atributimit në këto tri relieve bën të mundur që Ndreut t'i atribuohet edhe disa relieve të pasinifikuara të Shën Jeronimit, që gjenden në disa vende në Dalmaci dhe në botë. Kështu, në

“Relievin e parë kushtuar Shën Jeronimit, Ndreu e punoi në Pagëzoren e tij të Trogirit, kurse njëzet vjet më vonë e ndërtoi përsëri relievin Shën Jeronimit për kishëzën e asketëve të Shën Jeres në Marian të Splitit. Edhe sot është e ruajtur kjo shpellë askete, në të cilën me shekuj kanë jetuar asketët pranë kësaj kishëze mbi altarin e të cilit Andreu e ka ndërtuar relievin e vet me përkushtim dhe emrin e vet si dhurues (*Andreas lapicida*) dhe me shënimin e vitit 1480 si vit i dhuratës.”

Galerinë e Arteve në Split ruhet një relief i Jeronimit (39 x 36,5 cm.) i punuar prej gurit të Trogirit. Në kishën e Shën Gjonit në Zarë është zbuluar reliefi i Shën Jeronimit me dimensione të ngjashme (34 x 35 cm.) si kurse ai i mëparshmi dhe duke e krahasuar përsëri me relievin e Marianit (“forma e shpellës është e ngjashme, përpunimi i murit gjithashtu, i njëjti është edhe vendosja e luanit, librit dhe gjarprit”). Stidiusi nga Zara, I. Petriçoli konsideronte se, “relievin e Zarës dhe të Marianit e ka punuar i njëjti mjeshtër” dhe se “mbasi në relievin e matjanit është nënshkrimi i Andreut mund të supozohet me siguri se Andreu është autor i relievit të Zarës”. Në lapidarin e Dubrovnikut gjendet gjithashtu një relief i ngjashëm (38 x 40 cm.), që më parë ka qenë murosor buzë kishës së Zojës së Kashtelit në Dubrovnik. Për këtë, studiuesi, Kr. Prijatelj konstatonte se përkundër disa ndryshimeve ekziston “ngjashmëri e padyshimtë” në mes të relievit të Dubrovnikut dhe të Splitit.


Në bazë të këtij relievi C. Fiskoviq dhe Petriçoli me oficinën e Ndreut e kanë lidhur relievin e Shën Jeronimit (madhësia 31 x 39 cm.), që gjendet i murosor nën rrasën e varrit të Gaspar Bolduit në kishën Santa Maria de Ciglio në Venedik. Gjithashtu, në Dubrovnik gjendet edhe një relief, përsëri me madhësi të ngjashme (37 x 39), që vjen nga Sllano, dhe është i vendosur në Galerinë e Arteve. Ky relief ndryshon pak nga ata të mëparshmit për nga tretmani i shpellës, rrudhat e rrobave dhe shenja e re ikonografike në formë të kryqit.

Në të gjitha këto relieve të përmendura të Ndre Aleksit, Shën Jeronimi është paraqitur në mënyrë besnike ikonografike si asket në shpellë me luanin, gjarpurin dhe shkrapin. Ky i shen-

jë është mbrojtës i Dalmacisë, prandaj edhe Ndreu e punoi disa herë, qoftë sipas logjikës së porosisë, qoftë për interesimin e tij për një figurë asketi dhe për botën magjike të peizazheve të tij. Kompozicioni është shumë i bukur. Portretin e Shën Jeronimit të realizuar nga Ndreu e përshkruan bukur studiuesi Kr. Prijatelj me këto fjalë: “Shenjtë rri i qetë dhe i natyrshtë, kurse lojën e bukur të vijave e krijon këmbët dhe shkopi në tërësinë e përbashkët të kompozuar me mjeshtëri”. Dhe për fund, duhet theksuar se Ndre Aleksit vitet e fundit të jetës së tij ia dhuor relieveve të Shën Jeronimit.

Shën Jeronimi është paraqitur në më se 300 punime të autorëve

të ndryshëm të Evropës, si të Leonardo da Vinci, Vittore Carpaccio (me origjinë arbërore), Caravaggio, Giovanni Bellini, Albrecht Altdorfer, Antonello da Messina, Alessandro Botticelli, Andrea del Castagno, Cima da Conegliano, Albrecht Dürer, Anthony van Dyck, Francesco Fontebasso, Domenico Ghirlandajo, Giotto, El Greco, Georges de La Tour, Lorenzo Lotto, Fra Filippo Lippi, Pietro Peru, Raphael, Peter Paul Rubens, Rogier van der Weydenku, etj. është paraqitur si kardinal në shkëlqimin e purpurit, është paraqitur si intelektual në bibliotekë dhe është paraqitur si monak mistik i manastirit lindor. (Fund)



Shën Jeronimi – pikturë

kritikë letrare

Letërsia e Atë Gjergj Fishtës (III)

Fishta në zhvillimet letrare dhe kulturore, niset me një projekt letrar, dhe këtë shohim qartë se e jetëson përmes një strategjie letrare. Në këtë strategji, krijimi i tekstit poetik ka një qëllim, një funksion, dhe në të njëjtën kohë përcjell një ide-mesazh. Në zhanrin e epikës, te teksti "Labuta e Malcis", Fishta jep totalitetin e mundshëm të historisë shqiptare, duke zbritur në të kaluarën dhe duke kënduar aktualitetin, si premisë për të ardhmen. Përmes dijes empirike letrare, autori thithë në përmasa eksplicite kulturën e letërsisë orale, ngjarjet dhe personazhet e njohura nga diskursi historik e orale, thith kodet tematike e retorike, të së cilat i hibridizohen, mbivendosë, kombinon dhe i ridistribucion përmes mekanizmave poetik në strukturën e tekstit, për të funksionalizuar e formësuar diskursin epik, i cili ka shenjat poetike personale dhe ndikimet intertekstuale, sidomos ato që vijnë nga lloji përkatës poetik

■ Shkruan:
Ndue UKAJ

Letërsia si dialog

Letërsia është dialog, mbase dialog permanent, që zhvillohet në relacione të gjera, në të cilat relacione të dialogimit, bota e plotfuqishme artistike autoriale ka statusin special. Poiesisi (krijimi nga asgjëja, sipas Aristotelit), mbetet në këtë rrafsh përcaktues i qenësisë së letërsisë. Krijimi poetik në kuadër të korpusit të letërsisë së Fishtës, në të shumtën e herëve konstruktivohet duke ruajtur natyrshëm referenca letrare a kulturore. Kjo letërsi ka modelin, riprodhohet përmes modelit dhe simboleve kryetipore (Fraji), si pjesë e imazheve që merr sistemi psikik krijues në procesin e shkrimit. Ky nivel letrar në relacion me diskursin *autorial-personal*, rrafshi i së cilit dallon artikullimin e pastër fiksional të autorit, në relacion me rrafshin tjetër, i japin korpusit të letërsisë së Fishtës, karakter polisemantik edhe në planin e topikës, po ashtu edhe të diskursit.

Mendimi i lartëshkruar që koncepton letërsinë si dialog, na shpie te vlerësimi: duke qenë letërsia dialog permanent interaktive dhe dinamik, produkti i kësaj genie letrare, që është teksti letrar/estetik, dialogun e bën me tekste që janë të shkruara më herët, të fushës së letërsisë dhe joletërsisë, por që kanë cilësi letrare. Si të këtylla, përgjallojnë sipas sajësës së sojit letrar (zhanrit). Tekstet letrare të Fishtës krijojnë analogji brenda llojit letrar, por edhe veçmas. Sidomos në letërsinë e Fishtës, gjejmë tekste që derivojnë dhe humbin në esencë natyrën origjinale. Tragjedinë "Juda Mukabe", Fishta e shkruan në vargje, përkundrazi shkrimi origjinal që është në prozë. Po ashtu, inkorporimi i personazheve letrare, citave a figurave të ndryshme, leksikut apo rrjeti i toposit (temave dhe motiveve), në letërsinë e Fishtës merr fuqishëm karakter personal, stil të veçantë, që është stili fishtian, i

karakterizuar fund e krye në nga diskursi specifik i shkrimit letrare ligjërimitor dhe që ka një karakteristikë të përhershme, që Michel Fuco e thekson si *Diskursi i Fuqisë* (Power discourse). Në këtë kuadër, duhet përmendim rrjetin predominant që kanë ndikuar në letërsinë e Fishtës, siç janë veprat e lashta të antikitetit greko-romak, *Iliada*, *Odisea*, *Eneida*, pastaj *Bibla* dhe *letërsia orale*.

Studimet bashkëkohore të letërsisë, kanë avancuar me metodën që i analizojnë tekstet në rrjet, duke i parë në lidhje të ngushta me tekstet pararendëse.

Teoritë e këtylla, tashmë i mbështesin dijetar të shumtë të studimeve letrare, dhe atë të disiplinave të ndryshme. Mbase, mendime të kësaj kategorie ndeshim edhe në antikitet, edhe pse të paformuluara si kur sot. Kështu

në *Artin Poetik* të Horacit gjejmë këtë sugjerim për shkrimtarët: "*shprehja e krijuar rishtazi do të ketë vlerë të qëndrueshme*". Ky është dimension i intertekstual i letërsisë, të cilin aspekt të letërsisë e shpreh Roland Barti kur pohon në formë përkufizuese se: "*çdo tekst, është intertekst*". Ndërsa edhe semilogu i njohur i letërsisë Umberto Eco, kur diskuton për ndikimet letrare shkruan: "*gjeja më interesante është se librat flasin mes vetë*". Rrjeti intertekstual i tekstit letrar i jep statusin poli/letrar. Duke interkomunikuar, duke "folur", librat njëra me tjetrin, natyrshëm marrin e japin trajta të ndryshme letrare, "shfrytëzojnë" njëra-tjetrën, për të thithur përvojat e qëndrueshme letrare dhe diskursin, që në transformimet letrare merr shenjë autoriale, nga fakti se çdo libër letrar ka vullën e origjinalitetit, të cilën ja jep stili autorit, i cili në kuadër të ndikimeve intertekstuale, gjithëherë

ruan aspektin autorial si pjesë e natyrshme e sistemit fiksional të krijimit. Në sensin e kësaj ideje letrare, kërkimi i letrarisë në kuadër të veprës letrare të Fishtës, si tërësi, përmes aplikimit të modelit interkomunikues mes literaturës, pra nga konteksti se librat "flasin" me libra tjerë, me kultura e modele të ndryshme ligjërimit, të cilat qoftë si sekuenca narrative letrare, apo edhe tërësi diskursesh, paraqesin, posaçërisht dimension me rëndësi në konfigurimin e tekstit poetik të Fishtës, paraqet një aspekt të rëndësishëm dhe me mjaft peshë

“ Krijimi poetik në kuadër të korpusit të letërsisë së Fishtës, në të shumtën e herëve konstruktivohet duke ruajtur natyrshëm referenca letrare a kulturore. Kjo letërsi ka modelin, riprodhohet përmes modelit dhe simboleve kryetipore (Fraji), si pjesë e imazheve që merr sistemi psikik krijues në procesin e shkrimit. Ky nivel letrar në relacion me diskursin *autorial-personal*, rrafshi i së cilit dallon artikullimin e pastër fiksional të autorit, në relacion me rrafshin tjetër, i japin korpusit të letërsisë së Fishtës, karakter polisemantik edhe në planin e topikës, po ashtu edhe të diskursit. ”

në kuadër të kuptimit të korpusit të autorit tonë.

"Të lexosh diçka si letërsi është ta trajtohet atë si një ngjarje që ka kuptim në lidhje me ligjërimet tjera" (Xhonatan Keller). Letërsia e Fishtës është pikë ku gjenden trajta të njëjtimit të ligjërimeve të ndryshme letrare e kulturore, që si të tilla përbëjnë në vetë rol të rëndësishëm letrar dhe përmes së cilës nxjerrim kuptimet e ligjërimeve të ndryshme të qenies njerëzore dhe botës së letërsisë.

Teoricieni dhe poeti genial antik Horaci, në vargjet brilante poetike, por edhe teorike kritike, sugjeron shkrimtarët e gjitha brezave: "*Ju që shkruesi, zgjedhni lëndën që u përshatet fuqije dhe mendonin gjatë së çfarë mund e çfarë s'mund të bartni mbi supet tuaja*", për të shtuar se "*shprehja e krijuar rishtazi do të ketë vlerë të qëndrueshme*". Sugjerimin në fjalë, Fishta e bën pjesë funksionale të letërsisë së tij më vetëdije të plotë krijuese,

për ta zbatuar me devotshmëri krijuese në gjitha zhanret letrare. Sidomos në aspektin e rikrijimit të trajtave të njohura letrare, që tekstet e Fishtës i bën të gjalla, dinamike dhe sugjestionuese, përmes frazeologjisë dhe gjuhës popullore dhe dialektit geqe, që bën krejt e veçantë në kulturën letrare shqipe këtë lloj shkrimi.

Gjergj Fishta dijet letrare i zhvilloi përmes asimilimit të kulturës së lashtë folklorike, me atë mitologjike. Ernest Koliqi mendon se Fishta landën letrare për epikën e nxori pas kontaktit me botën e Malësorëve, ku ndesh

me destinimin; ky lloj *kangëtimi* influencon për të frymëzuar zemrat djaloshare për lirinë Atmes e fesë, që ishte projekt letrar e kulturor i Fishtës, i nisur fillimisht, më himnizimin e trimërisë, lavdisë, bukurisë shqiptare, kujtesës historike, implikon, pastaj diskursin historik, me përmasat e mitit për prejardhjen lashtë Ilire, dhe për kohën e lavdisë me Gjergj Kastriotit: komponente këto që do të bëhen hallka të rëndësishme në orkestrimin e letërsisë së tij, sidomos epikës dhe lirikës. Duke pasur për bazë këta komponentë, autori krijon disa lloje të diskurseve. Në këtë rrafsh, diskursi historik është përcaktues, por përmasa diskursit gloriifikues e shforcon ligjërimin historik dhe i jep intencionalitet më të fuqishëm e më kumbues. Këtë autori i bën përmes *diskursit të fuqisë* (Michel Foucault) që ka potencë të thellë krijuese. Por çka ndodh, ky lloj diskursi përfundon në kontrastin letrar, në sarkazëm therës e rrënqethës, që të trandë shpirtin e të ngjeth trupin, kur shkrimtari godet pamëshirshëm dvrësit e idealeve dhe qëllimkëqijtë e kombit. Jo vetëm në satirë, por edhe në epikë e lirikë ndeshim nuanca të shumta të këtij lloj diskursi. Kjo domethënë se autori nuk donë kompromis me prishësit a thyerësit e idealit të misionarit. Në të vërtetë, ky soj ligjërimit më së miri gjen vetën në zhanrin e satirës, ku Fishta tejkalon kornizat konvencionale të shkrimit letrar, edhe të lirikës edhe të epikës. Këtu diskursi gloriifikues tretet, dhe gjitha dobësitë shqiptare autori i merr në thumbim. Në fakt, këtu Fishta përdor kamzhikun. Mu sikurse bariu i tij shpirtëror biblik, kryetipi njohur nga mësimet biblike, dhe me të fishkëllën gjithë ata që devijojnë idealeve të projektit shqiptar për emancipim e liri, si projekt autorial. Në këtë rrafsh, Fishta ndërton analogji implicite me ngjarjen biblike, kur Jezu Krishti, në Sinagogë sheh të bëhet tregti dhe merr kamzhikun e fishkëllën me të. Ky dimension i sim-



Atë Gjergji Fishta me Don Dedë Kolecin (1908)

bolik i teksteve, që Northrep Fraji i analizon në kontekstin e përfytyrimeve që kanë ngjarjet, personazhet në shkrimin letrar, edhe pse i padukshëm në sipërfaqen e jashtme të tekstit lexohet nëse analizohet në kontekste të ngjarjes së përmendur.

Teoricien i mendimitari i letërsisë Roland Barthi, shkruante: "teksti është një endje citimesh që vijnë nga mijëra kultura". Ky mendim i Barthi mund të "shërbejë" në shumë nivele sprovues, domethënë në mëtimet/kërkimet tona, ngase në tërësi është një sistem i autorit, në të gjitha zhanret ku shkroi letërsi, funksionin si *endje funksionale citimesh*, ngjarjes e personazheve që vijnë nga kultura të ndryshme të njohura në kulturën tekstuale shqiptare apo edhe dimensionet universale të shtrijës së botës së letërsisë.

Fishta në zhvillimet letrare dhe kulturore, niset me një projekt letrar, dhe këtë shohim qartë se e jetëson përmes një strategjie letrare. Në këtë strategji, krijimi i tekstit poetik ka një qëllim, një funksion, dhe në të njëjtën kohë përcjell një ide-mesazh. Në zhanrin e epikës, të tekstit "*Labuta e Malcis*", Fishta jep totalitetin e mundshëm të historisë shqiptare, duke zbritur në të kaluarën dhe duke kënduar aktualitetin, si premisë për të ardhmen. Përmes dijes empirike letrare, autori thithë në përmasa eksplicite kulturën e letërsisë orale, ngjarjet dhe personazhet e njohura nga *diskursi historik e orale*, thith kodet tematike e retorike, të së cilat i hibridizohen, mbivendosë, kombinon dhe i ridistribucion përmes mekanizmeve poetik në strukturën e tekstit, për të funksionalizuar e formësuar diskursin epik, i cili ka

shenjat poetike personale dhe ndikimet intertekstuale, sidomos ato që vijnë nga lloji përkatës poetik. Shenjat poetike referenciale shfaqen edhe në planin kompozicional (të jashtëm, që shenjë e parë e ka në formulimin *Labuta*, dhe mbiemërzimin e *Malcisë*, që nënkupton një vendbanim të njohur gjeografik, që implikon llojin e këngës me ritëm e elemente të diskursit përshkrues që del nga fushëveprimi ambiental). Model letrar, i përshtatshëm për Fishtën, mbetet kultura retorike e komunikimit poetik me elemente heroike: (autori fillon me bariun Marash Ucin, Oso Kuka, Tringën, Dedë Gjo Luli, Naim Frashri e përfundon me Abdyl Frashrin, etj.), të ndërthurura në një planë tjetër nga shfrytëzimi i mitologjisë së lashtë (përmes Zanave, Orëve, Dragonjeve). Për të sforcuar diskursin, autori kurdoherë referencat, citatat, shenjat, ngjarjet i transformon në mënyrë eksplicite për t'u jetësuar në dritën e kohës, me metafora e krahasime e gjetje brilante poetike. Edhe pse teksti epik ndërtohet sipas modeleve klasike të epëve, në esencën e shenja letrare gjejmë shtratin e kulturës retorike shqiptare, përmes leksikut, fjalëformimit, figurshmërisë, elemente këto që përgallojnë nëpër ambientet e përditshmërisë shqiptare. Gjitha këto elemente bazike, brenda strategjisë së autorit për tekstin, pra projektimet ideore dalin të përpunuara mjeshhtërisht. Autori empirik thërret referentin, për t'i shpërthyer ekzaltimet shpirtërore, idetë letrare dhe me narrativën ndërton një relacion shkallë-pasojë. Rrjedhimisht, këtë filozofi krijuese, autori empirik e shpreh në vargun fillues të "*Labutës...*", përmes së cilit varg sugjeron dhe

“ Në letërsinë e Fishtës, gjejmë tekste që derivohen dhe humbin në esencë natyrën origjinale. Tragjedinë "*Juda Mukabe*", Fishta e shkruan në vargje, përkundër shkrimit origjinal që është në prozë. Po ashtu, inkorporimi i personazheve letrare, citateve a figurave të ndryshme, leksikut apo rrjeti i toposit (temave dhe motiveve), në letërsinë e Fishtës merr fuqishëm karakter personal, stil të veçantë, që është stili fishtian, i karakterizuar fund e krye në nga diskursi specifik i shkrimit letrar ligjërimitor dhe që ka një karakteristikë të përhershme, që Michel Fuco e thekson si Diskursi i Fuqisë (*Power discourse*). ”

njëherit thekson në formë kushtruese intencën letrare, duke kërkuar mbështetjen e Zotit, për të kënduar gjallimin e kombit, në pesëindvjetët robërisë turke, që kishin pllakosur vendin në një prapambeturi tmerruese, shenjat denigruese të së cilës kishin bërë të zvetonheshin ato idealele kastriotiane: "*Ndihmo Zot, si m'ke ndihmuë*". Kjo hyrje filluese, njëherit na sugjeron futjen në lojë të dimensionit intertekstual e interdiskursiv të tekstit, i cili në rend të parë i referohet filozofisë së tij religjioze, së dyti modelit epik, për të bërë të ditur se në këtë tekst rrëfëhet, tregohet, pra ka narracion për një ngjarje të caktuar në të cilën ai krijon të ndërtojë marrëdhënien mes narrativës dhe audiencës. Fishta kërkon referentin për të nisur kangëtimin e nacionit dhe me këtë referent vepron tutje, duke u bërë teksti i tij endje funksionale citimesh e ngjarjes që vijnë nga kultura dhe letërsia të ndryshme. Hyrja në Lahutë, shenjëon edhe një analogji me "Iliadën" e Homerit. Këndo hyjsheshë mërinë e Akilit. Vetëm dallon narracioni. Të Fishta kemi interkomunikim të drejtpërdrejtë poet/zot, ndërsa të Homerit kemi *narracion atributive*.

Letërsia e Fishtës zhvillohet në një kontekst kulturor dhe letrar që dominohej nga retorika heroike që përcillte zhvillimet shoqërore dhe transformimet e shumta dhe shumëdimensionale. Kjo dominancë, deri diku, vetvetiu nënkupton edhe modelin letrar dhe diskursin, i cili natyrshëm ka shenja të fuqishme të korrespondimit të thellë me këtë gjendje, motivohet prej saj dhe ka këtë synim letrar.

Në këtë univers, rëndësi kanë edhe rugët e formësimit të autorit, ajo që *Sbarl Lalo* e quan *psikologji autoriale*. Ky estet i njohur frëng duke diskutuar aspektin psikologjik në veprën dhe në kapitullin "*Estetika psikologjike*" duke shkruar për personalitetin, sineritetin dhe fikcionin shkruan: "*Shpesh përsëritet se vepra duhet të jetë shprehje e personalitetit të autorit të saj dhe se, sa më personal që është, aq më e bukur del*". Shenjat me autentike të estetikës së tekstit të Fishtës, formësohet përmes dy komponentëve të rëndësishme estetike: *dijsë paraprake letrare*, në formë të një *parakonceptimi që ndërton autori për letërsinë në rrugën e formimit të tij artistik*. Në këtë rrafsh, doemos inkudrohet edhe talenti krijues, fikcionaliteti, që përbehen bashkë me modelet pjesë e "*genies letrare*" të letërsisë.

Letërsia e Fishtës në esencën e saj ka vulën e gjendjes shoqërore. Autori njihte mirë trendet letrare në kulturën letrare perëndimore. Por kundronte gjendjen dhe zgjidhte dilemat e tij; për shqiptarët nuk ishte momenti të shkruhej letërsia e dimensioneve që përfaqësonin shembull, autorët si Kafka, Xhojsi e Kamy, por duhej sforcuar morali, duhej mobilizuar për të shpëtuar ekzistencën, duhej, në fund të fundit, të motivohej një shpirt kombëtar i degraduar në synim për liri e pavarësi. Në këtë synim, Fishta zgjodhi lëndën që i *përshtatej fuqive të tij krijuese* (Horaci), por edhe artikuloi pozicionin e fuqishëm kundruall audiencës letrare dhe presupozoi një audiencë të caktuar letrare. Duke e ditur se kulturës letrare shqipe i mungonte një tekst themelor nacional i identifikimit, Fishta iu rrek shkrimit të epik, kur ky zhanër i përkiste së kaluarës. Dhe në këtë qëllim, autori e kuptonte se më së miri, mund të ndikojë epopeja kombëtare, që do të këndonte përpjekjet për pavarësi, vështuar në planin historik dhe perspektivë, e cila veprë i mungonte letërsisë shqipe. Këtë gjë nuk e kishin bërë më parë as autorët si De Rada, Naimi, Noli, Skiroi, përkundër përpjekjeve të herëpashershme. Dhe ndërtoi një simfonie epike brilante, e cila pati ndikim të jashtëzakonshëm jo vetëm në botën letrare, por edhe në përgjithësi në audiencën e shumtë, që u bë model. Fishta donte që letërsia të influencojë.

Fishta ishte njeri religjioz me formim, i ndërtuar mbi mësimin e krishterë dhe bibliik. Ky segment, do të bëhet dimension fundamental, që i jep shenjëon autoriale, ngjyrë krijimtarisë së tij, parashenja e së cilit zë fill me artikullimin e projektit bazik autorial për *Atme e Fe*, postulate rreth së cilit sillet pjesa dominonte e krijimtarisë së tij. Fishta si bari shpirtëror dhe frate françeskan (rregull i krishterë që ka si objekt jetën sa më të vështirë, për t'u ndihmuar të tjerëve), i gjen-dur në një ambient ku funksionon në përmasa të mëdha kodi oral i jetës dhe i organizmit shoqëror (në Malësi), del në furtunat letrare dhe shkruan nga pozicioni i artistit, duke aplikuar një diskurs të fuqishëm. I mahnitur nga madhështia e bujaria e shpirtit të malësorëve, Fishta krijon miqësi me njerin nga malësorët, i cili do të bëhet edhe personazh i rëndësishëm në "*Lahutë e Malcis*", me Marash Ucin, personazh letrar i dokumentuar historik, i cili do të

ndikojë shumë në epikën e tij. Po ashtu njihet për së afërmi me trajta të moçme folklorike, të cilat i absorbbon dhe i funksionalizon duke ju dhënë stil të veçantë poetik. Jashtë këtyre pikave të rëndësishme, për të kuptuar natyrën e letrarisë së Fishtës, mbetet me rëndësi të përmendim edhe përvijojën letrare, si fushë empirike autoriale për letërsinë që zë fill me kontaktet e tij me letërsitë sllave, gjatë studimeve të tij në Sarajevë. Për këto Fishta në flet edhe vete në diskutimet e tij për artin dhe estetikën, përsiatjet që shpalosin karakterin shkrimtarit. Autori është lexues i pasionuar i autorëve të mëdhenj antikë, prej së cilëve magjepsje.

Gjitha këto ndërlidhën në literaturë përmes një indii, i cili njih shndërrimet e mëdha, të cilat i gjejmë në veprën e tij letrare; shndërrime do thoshim epokale, të cilat i përjetonte populli shqiptar, barrën kryesore të së cilës natyrisht e kishin intelektualët dhe shkrimtarët; nga të cilat zhvillime Fishta nuk shkëputet asnjë qastë; kalimi nga joliria drejtë lirisë, emancipimit dhe konsolidimit të kombit shqiptar, është beteja në të cilën Fishta artikulon vetën në art. Në fakt, Shqipëria dhe shqiptarët gjendeshin në një djerrinë kombëtare, por edhe religjioze. Nga i cili aspekt edhe motivohet shkrimi i bazuar në dy komponentë *Atme e Fe*, të cilat marrin trajta poetike të jashtëzakonshme, personale për t'u bërë tema të mëdha të letërsisë së autorit; madje tema fundamentale, të cilat do të përshkojnë ligjëratën poetike të Fishtës, në kuadër të gjitha zhanreve letrare; veçanërisht epikën. Në fakt, përmendja e këtyre elementeve jashtëletrare, ka një motiv shpjegues për letërsinë e autorit. Sepse, prej këtij konteksti u motivua një pjesë e konsiderueshme e krijimtarisë letrare, ndikim që del në mënyrë eksplicite, me përjashtim të disa lirikeve dhe teksteve metafizike e kushtuese (religjioze). Gjithsesi një përjashtim nga ky kuadër paraqet teksti poetik "*Një lule vjeshhtë*", dhe si i këtillë del me status karakteristikë në kuadër të korpusit letrar fishtian, dhe që këndej shtron domosdënë e një ekstrainterpretimi, ngase aty Fishta përvijohet nga vetja, për të dalë i pastër në pasionin e tij krijues, në të cilën shpërfaq fuqinë brilante të këndimit poetik, duk mbetur larg zhvillimeve shoqërore.

(Pjesa e fundit në nr. e ardhshëm)

Kantuali Kishtar Shqiptar i Mons. Nikollë Minit

Edhe pse muzika, ndoshta, nuk zë vendin kryesor në veprimtarinë dhe krijimtarinë e Don Nikollës, mendoj se aty është i pari dhe më i miri, jo vetëm si interpretues, por edhe autor me individualitet të theksuar, në kohën kur ne të tjerët kemi punuar edhe në këtë lëmi, por nuk i kemi shfaqur për shkaqe të njohura.

■ SHKRUAN:
AKIL KOÇI

Muzika sakrale/e shenjtë ndër trojet shqiptare dhe jashtë saj, nuk ka ndonjë traditë të gjatë. Sidomos ajo në Kosovë, lirisht mund të thuhet, as që ka ekzistuar në mënyrë të organizuar, nga se nuk kemi pasur ndonjë traditë dhe profesionistë muzikorë që janë marrë ekskluzivisht në mënyrë profesionale me këtë degë të artit, pos muzikës popullore. Edhe ka qenë e natyrshme ta kemi një gjendje të tillë, duke ditur situatën që ka mbretëruar.

Në Shkodër dhe Prizren, si dy qendra të kulturës shqiptare, e sidomos të asaj katolike fetare, është kultivuar në një masë të caktuar muzika sakrale. Sidomos Prizreni ka qenë në një situatë më të vështirë, sepse pos priftërinjve dhe motrave të nderit që kanë punuar në Katedralen e Prizrenit, nuk kemi pasur ndonjë profesionist që është marrë në mënyrë intensive e profesionale.

Shkodra ka pasur një varg krijuesish, të cilët pas shkollimit kanë krijuar vepra në traditën e muzikës romantike evropiane, siç janë kompozitori i shquar Atë Martin Gjoka OFM, Kardinali Mikel Koliqi, por edhe ndonjë tjetër, për të cilët do të shpalosim më gjerësisht në një punim të veçantë për jetën dhe krijimtarinë e tyre. Përveç këtyre dy krijuesve të dalluar, ka kompozitorë të shquar, si: Frano Ndoja, Palok Kurti, Prenk Jakova, Çesk Zadeja dhe një sërë krijuesish të afirmuar, për të cilët ka shkruar mjaft edhe Prof. Dr. Eno Koço, dirigjent i njohur, i cili thotë: „Muzika kishtarë ka pasur ndikim në praktikën e traditës muzikore lokale të një pjesë të kompozitorëve katolikë shkodran, kjo është e vërtetë, por që kjo traditë mbarte tipare të fuqishme krahinore e kombëtare, kjo është edhe më se e vërtetë.” Pra, deri sa Shkodra kishte kompozitorë që krijojnë vepra të muzikës origjinale sakrale, siç janë nga Atë Martin Gjoka, Mesha për ATB dhe harmonim që në vitin 1913 dhe një sërë veprash të tjera, Kosova dhe Prizreni kanë pasur këngë nga tradita dhe të përkthyer.

Nëse shohin çka ka ndodhur në muzikën sakrale evropiane

në tërësi, ne kemi qenë jashtë të gjitha ngjarjeve duke i falënderuar „dhuratës” pesëshekullore të sundimit aziatik në trojet tona.

Në të pesë periudhat e historisë muzikore, siç janë renesanca, baroku, klasika, romantizmi dhe shekulli i njëzetë, është kultivuar në masë të madhe muzika sakrale, krahas formave të tjera muzikore në botë. Kështu, bie fjala, Giovanni Perluigi da Palestrina (1525-1594), është kompozitori më i spikatur dhe mjeshtër i Meshës katolike në periudhën e renesancës. Por, me që hapësira nuk na lejon, nuk do ta shtrojmë këtë temë më gjerë, do t'i kthehemi muzikës sakrale shqiptare në Kosovë.

Në numrin 1/2007 të revistës „Drita”, e përmuajshme e Kishës Katolike në Kosovë, në rubrikën përvjetor (fq.10-11), lexova tekstin kushtuar Monsinjon Nikollë Minit, të autorit Pjetër Përgjoka, me rastin e 15-vjetorit të vdekjes. Autori na u paraqit me këtë shkrim prej një diskursi të një autobiografi të ndershëm, i cili shpalos pjesë nga biografia dhe jeta e tij, edhe pse mundësia ka qenë më e madhe për një refleksion më të hapur, më të gjerë, për të qenë më bindës për këtë meshtar, intelektual, prijës fetar, i cili ka qenë një ambasadë më vete, një figurë e madhore dhe koherente. Pavarësisht, që për të është shkruar mjaft mirë, mendoj se i kemi mbetur borxh pa i cekur më gjerësisht meritat e tija prej një reformatori, krijuesi dhe autori i të gjitha atyre punimeve që i bëri në kohën kur populli dhe besimtarët kishin nevojë të madhe për edukim. Me gjithë se një segment i veprimtarisë së monsinjon Minit nuk është rrahur sa duhet në atë shkrim dhe sa e meriton, do përpiqem ta plotësoj autorin e shkrimit për Monsinjon Don Nikollë Minin, i cili si duket, nuk ka pasur njohuri dhe nuk i ka cekë shumë gjëra, konkretisht e kam fjalën për muzikën sakrale.

Ai përmend botimin e Kantualit kishtar shqiptar në vitin 1974, organizimin dhe aktivitetin e korit të kishës, pjesëtarë i së cilës kam qenë edhe unë si fëmijë dhe jetëvjeçar gjatë viteve 1946-47, që udhëhiqej nga motrat e nderit m. Angelina dhe m. Ana. Edhe pse muzika, ndoshta, nuk zë vendin kryesor në veprimtarinë dhe krijimtarinë e Don Nikollës, men-



“Marrë në tërësi, Kantuali Kishtar Shqiptar, është një libër këngësh mjaft modest por shumë, shumë i vlefshëm, jo vetëm për kohën në të cilën është përdorë, por edhe për historinë tonë të re muzikore, e sidomos për gjeneratat e muzikologëve – të cilët as që ekzistojnë fal interesimit të profesorëve në Fakultetin e Arteve të Prishtinës – tanë të ardhshëm, për të pa se në çfarë gjendje ka qenë muzika sakrale në atë kohë.”

doj se aty është i pari dhe më i miri, jo vetëm si interpretues, por edhe autor me individualitet të theksuar, në kohën kur ne të tjerët kemi punuar edhe në këtë lëmi, por nuk i kemi shfaqur për shkaqe të njohura. E kam fjalën për botimin e Kantualit kishtar shqiptar, që, me sa kam dijeni, është i pari i këtij lloji në Kosovë, botuar nga Meshtarët e Ipeshkvisë Shkup-Prizren, i botuar në vitin 1974. Tani kemi edhe kantual tjetër, siç janë „I Këndojmë Zotit” nga Imzot Patër Hili; libri i Beranardina Mjedës, dy librat e Vinçenc Gjini, ka botime interne dhe disa CD me këngë të incizuara.

Kantualin e Don Nikollës, Ordinariati Ipeshkvnor Shkup-Prizren, lejoi të shtypet me rastin e kremtes së Zojës, Nënës së Këshillit të Mirë, të nënshkruar nga Imzot Nikë Prela, ipeshkëv, ku mes tjerash ai thotë: „Ky kontribut i përpjekjeve Tuaja i cili nuk është i vogël e deri tani unik, ka për ta plotësuar mungesën e deritasme të një libri kësendore për pjesëmarrjen në jetën liturgjike të popullit tonë. Duke e bekuar këtë punim, besoj dhe shpresoj se do të jetë një nxitje për një gjurmim dhe të mëtejme, të dobishëm dhe të suksesshëm për ta shpëtuar nga humbja thesarit e shpirtit të popullit tonë të pasur e të shprehur në melosin popullor-fetar.

Prandaj le të shtypet. Në rastin e kremtes së Zojës, Nënës së Këshillit të mirë. Në Ferizaj, më 26 prill 1974 Imz. Nikë Prela, ipeshkëv.”

Pra, botimi u prit me shumë dashuri, sepse me atë drituri që kishte Monsinjon Mini, realizoi dëshirën e kamotshme që grigjës së vet t’ia dorëzojë dhe ta pajisë me këngët që përdorëshin me rastin e Meshëve të të gjitha llojeve, tani si doracak me fjalë dhe nota, të cilin e quajti „Kantuali kishtar shqiptar”.

Nga përbajtja e Kantualit do të shohim se autori ka prezantuar këngë për nevojën jo vetëm të meshtarëve, por edhe besimtarëve, prandaj edhe e ka nda Kantualin në disa pjesë si janë: *Mesha korale, Këngë të Meshës, Ardhja, Këshillat, Krezhmet, Pashkët, Rrëshajët, Krishti, Sakramendi, Bekimi me Sakramend, Zojës së bekueme, Shejtrit, Këngë rasti dhe Mesha.*

Nuk kemi shënime se nga janë marrë këto këngë, por nga analizat e përcipta mund të vërehet se shumica janë të përkthyer nga gjuhët e huaja dhe nuk kanë autorë, por nuk hasim as në bibliografinë e nevojshme në këso raste, edhe pse në kantualet e shteteve me traditë më të madhe të muzikës kishtarë do të jenë prezantuar edhe autorët. Prandaj për t’i kërkuar autorët e të gjitha këtyre këngëve, na duhet një kërkim më i gjithanshëm.

Të fillojmë radhazi, në pjesën e parë të cilën e ka quajtur *Mesha Korale*. Në këtë pjesë gjenden: *De Angelis (Mesha Korale)*, me pjesë *O Zot, Lumtëri, Shenjt dhe O Qingji i Hyut.*

Në *Këngët e Meshës*, autor i se cilës është kompozitori Jozef Haydn (1732-1809), kompozitor i njohur Austriak me pjesët *Në Fillimi, në "Lumni" I, në "Lumni" II*, dhe në *Besoj*.”

Në pjesën e tretë *Ardhja*, kemi këngët *„Eja shpejt”, „Drejt prej qiell”, „Nana Shejt”, „Nanë e Mesjes”, „Qe, o Mari”, „Bini lulë”, „O Nazaret” dhe „O Mari nanë”.* Prej këtyre tetë këngëve duhet të veçojmë këngën *„Qe, o Mari”,* këngë e shkurtër dhe mjaft e bukur.

Në këngët/rubrikën e Këshndellavet kemi 19 këngë, të gjitha të njohura dhe të bukura duke filluar që nga „*Bukuri na duet*” *„Kirie eleison”* *„Këndoni lumni ejet”* *„Gloria”,* *„Sot te shpella e Belemii”* etj., të cilat këndohen me

ëndje. Kështu radhitën këngë pas këngë, të gjitha që lehtë këndohen ku është treguar një sens për nivelin e besimtarëve nga aspekti i ditorisë muzikore.

Kemi edhe mjaft këngë të krijuara nga populli, të cilat i kanë kënduar jo vetëm fëmijët, por edhe vëllezërit, motrat dhe prindërit tyre. Shumica e këngëve nuk kanë as ato shënime më elementare që duhet të ketë çdo këngë siç janë: tempoja, dinamika, përsëritjet dhe elemente të tjera që e përbëjnë atë. Autorët, pos dy këngë që i cekim të kompozuar nga Haydn, nuk kemi autor të tjerë, kurse në disa këngë është shënuar *Harm D. Nikollë Mini*, që aty s'ka të bëjë me harmonizim, por me shënimin e notave të cilat i ka quajtur si harmonizime.

Për sa i përket tekstit të këngëve, hasim në fjalë dialektesh të ndryshme, ai kryesisht Prizrenas dhe Shkodran, e sidomos dominojnë lokalizmat, kurse theksi arza e terza në melodi në të shumtën e rasteve nuk përputhet me theksin e fjalës. Vetëmelodisë ose i janë shtuar ose i janë munguar ca rrokje të fjalëve dhe ato nuk janë të ndara dhe kështu besimtari që i këndon duhet ta bëjë vetë. Disa këngë kanë strofa e disa nuk kanë, kurse teksti nuk ka ndonjë radhitje të duhur.

Përkrahimi i notave është amator, nëse shikohet nga kjo distance kohore, por i qartë. Aty këtu gjendet ndonjë vizatim mjaft me shije i bërë. Marrë në tërësi, Kantuali Kishtar Shqiptar, është një libër këngësh mjaft modest por shumë, shumë i vlefshëm, jo vetëm për kohën në të cilën është përdorë, por edhe për historinë tonë të re muzikore, e sidomos për gjeneratat e muzikologëve tanë të ardhshëm – të cilët as që ekzistojnë fal interesimit të profesorëve në Fakultetin e Arteve të Prishtinës –, për të pa se në çfarë gjendje ka qenë muzika sakrale në atë kohë, e asgjë më e mirë nuk është edhe në ditët e sotme, me përjashtime të disa famullive, ku me kore udhëheqin motrat e nderit që kanë dituri edhe nga muzika e në veçanti interesimi i tyre i madh për këtë lëmi. Mungon si më duket një punë me e organizuar e koreve kishtarë, sepse sa here kam pasur rast të dëgjoj, vërej se ato aspak nuk kanë përparuar, pos përsëritja e atij repertori, që vite me radhë i kemi dëgjuar, kurse koret janë në gjendje që pos këngëve të cekjekutojnë, të na befasojnë me ndonjë Motet, Pasije, Kantatë, Oratorium ose Meshë.


Pra, kontributi i Monsinjur Nikollë Minit në këtë lëmi është tejet i madh edhe për rreth ca vërejtjeve që i bëmë dashamirëse. Është jashtëzakonisht interesant, se këto pak botime që bëhen, nuk kanë recensentë profesional, pos disa, sepse, ai jep vërejtje dhe propozon që botim të jetë më i

kompletuar e jo pasi të botohet të bëhen vërejtjet. Është interesant të cekim edhe ca fjalë nga parathënia shkruar nga Dr. Gaspër Gjini, famullitar i Shkupit, i cili na sjell jo vetëm parathënie, por një shkrim ku do të hasim edhe një historik të vogël për muzikën shqiptare kishtarë, që nuk është trajtuar sa dhe si duhet edhe në ditët tona, kur kemi kuadro, kur kemi mundësi që të merren me një seriozitet më të madh.

Në parathënie e këtij Kantuali Dr. Gaspër Gjini, famullitar i atëhershëm i kishës katolike të Shkupit, shkruan: „Kabërë është ndie ndër ne nevoja për një përmbledhje këngësh kishtarë, të cilat këndohen si në meshë, ashtu edhe në raste të ndryshme liturgjike. Mirëfilli dibet se Kisha prej fillimit ka përcjell ritet fetare me këngë dhe melodi, të cilat shprehin shpirtin e një epoqe apo të një populli. Në këtë lëmi ne shqiptarët jemi tepër të varfër. Megjithatë, gjatë shekujve, duke falënderuar mbledhësve dhe përpunuesve të panjohur, dhe ndër ne është pasuruar deri diku melosi kishtar, janë përvetësuar meloditë e huaja duke dhënë një modalitet më të afërt melosist dhe shpirtit tonë, prandaj edhe populli i njëjti për të vetat. Me dashuri të madhe filloi këtë punë të pamiradishme fort e nevojshme Mons. Nikollë Mini,

famullitar i Prizrenit, i cili gjithë here është treguar si adhurues i muzikës kishtarë. Dhe, ja tani përgatiti këtë përmbledhje të bukur, të cilën në Vitin Shenjtë ia dedikon popullit të dashur shqiptar. Në radhën e parë janë përmbledhur këngët që me shekuj këndohen ndër ne, disa janë harmonizuar nga Monsinjori, e ka disa edhe origjinale që rrjedhin nga ata, të cilët donë dhe nderojnë Kishën. Në botimin e këtij libri na ka drejtuar dashuria ndaj kishës dhe popullit tonë. Shpresojmë se nëpërmjet të këngëve të tija besimtarët tonë edhe më tepër kanë për ta njohur dhe dashuruar bukurinë shpirtërore, Perëndinë, i cili është gurra e çdo bukurie, o si dikur tha muziktarit dhe besimtari i famshëm Josef F. Haydn „Duke menduar në Perëndinë zemrën ma kaplon një gëzim aq i madh, sa që çdo send në mua fillon të këndojë dhe të këndojë! Jemi të vetëdijshëm dhe për të metat që ka ky libër, si kurse çdo vepër njerëzore. Prandaj çdo vërejtje dhe ndihmë ka për të qenë një udhëzim më përmirësimit e edicioneve të ardhshme. Qoftë në nder të Hyut, Nënës sonë qiellore, shenjtërove, si edhe për shëlbim të shpirtërave. Shkup 26 prill 1974. Dr. Gaspër Gjini fam. i Shkupit.”

Pra hartuesi i këtij kantuali të parë dhe modest ka qenë i vetë dijshtëm që ka të meta dhe



zbrazëti të cilat, si thotë në fund të fjalës Dr. Gaspër Gjini, duhen kapërcyer në punën e mëtejshme, sepse autori muzikën nuk e ka pasur vokacion, por dashuri dhe se me plotë bindje e thotë dhe në mënyrë të sinqeritet që do të mënjanohej të metat për të i plotësuar zbrazëtitë në botimet e ardhshme.

Prandaj duke e mbyllur këtë artikull, shpresojmë se edhe më tutje ky kantual nuk do të mbetet si instance statike por aktive, jo vetëm duke i përdorur këto këngë gjatë Meshës por edhe duke huazuar nga ky kantual këngët për të krijuar në Kantual

të ri më të begatshëm, më profesional dhe më të përdorur siç janë kantualët e popujve që kanë traditë më të madhe në muzikën sakrale se sa ne.

Le të na shërbejë ky Kantual si pretekst për krijimin e veprave të reja, kantualëve të tjera, kurse ky le të ruhet si kujtesë dhe respekt, jo vetëm ndaj punës së autorit Monsinjur Nikollë Minit, por edhe ndaj këngëve të cilat i kanë kënduar gjyshërit, nënat, prindërit tanë dhe vëllezërit dhe motrat tona shekuj më radhë, dhe kështu shtrojnë përvojën e vjetër për të krijuar muzikën e re sakrale shqiptare.

Botime të reja




Don Pren Kola (zgjedhi dhe mbarështoi), *Shprehja e besimit dhe nderimit ndaj Eukaristisë – thënie dhe udhëzime*, Fjala Hyjnore, Prishtinë 2007, fq. 165.



Shën Augustini, *Katekeza për fillestarë* (përktheu nga italishtja: Dom Dritan Ndoci), Arqipeshkvia Shkodër-Pult, Shkodër 2007, fq. 96.

TA NDIHMOJMË NDËRTIMIN E KATEDRALES



Jam mik i Kishës Katolike dhe dua ta ndihmoj ndërtimin e Katedrales “Nëna Terezë” në Prishtinë!

Gjithë juve miq dhe bamirës të dashur ju mundësojmë ta jepni kontributin përmes xhirollogarive bankare. **Faleminderit!**



Raiffeisen Bank
Kosovo J.S.C.
Prishtina, Kosovo
SWIFT code: RBKORS22

Adm. Ap. e Prizrenit
Numri i llogarisë:

EUR: 1501 090000 1990 20
USD: 1501 090000 3765 30
CHF: 1501 090000 3764 33

Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A